

SULMET NDAJ GAZETARËVE DHE PUNONJËSVE MEDIATIK GJATË VITEVE 2017-2021 TENDENCAT DHE REKOMANDIMET



Autorë: Deniz Sulejman, Ivan Breshkovski

Shkup, mars, 2022

Për botuesin:

Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë (SHGM)

Autorë:

Deniz Sulejman, Ivan Breshkovski

Koordinimi:

Dragan Sekullovski

Lektorimi:

Dijana Ristova

Përkthimi në gjuhën shqipe:

Ferikan Iljazi Arifi

Ky publikim është falas dhe është përgatitur në kuadër të projektit "Promovimi i mbrojtjes së gazetarëve dhe standardeve etike dhe profesionale në media" të Misionit të OSBE-së në Shkup në vitin 2021.



Përmbajtja e këtij publikimi nuk përfaqëson medoemos këndvështrimet apo qëndrimet e Misionit të OSBE-së në Shkup.

PËRMBAJTJA

1	Hyrje	5
2	Metodologjia	8
3	Kategorizimi i sulmeve ndaj gazetarëve	11
4	Rishikimi i sulmeve ndaj gazetarëve dhe punonjësve mediatik në vitin 2017	15
5	Rishikim i sulmeve ndaj gazetarëve dhe punonjësve mediatik në vitin 2018	18
6	Rishikim i sulmeve ndaj gazetarëve dhe punonjësve mediatik në vitin 2019	21
7	Rishikim i sulmeve ndaj gazetarëve dhe punonjësve mediatik në vitin 2020	23
8	Rishikim i sulmeve ndaj gazetarëve dhe punonjësve mediatik në vitin 2021	27
9	Trende të sulmeve ndaj gazetarëve në periudhën janar 2017 - nëntor 2021	29
10	Sulme në internet ndaj gazetarëve	32
11	Dita ndërkombëtare për luftë kundër dhunës ndaj grave, nëpërmjet prizmit të Kombeve të Bashkuara	35
12	Siguria në internet e gazetarëve nëpërmjet raporteve të Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE)	37
13	Siguria në internet e gazetarëve nëpërmjet raporteve të Këshillit të Evropës	40
14	Rishikim i sulmeve në internet ndaj gazetarëve në RMV nëpërmjet praktikës institucionale	43
15	Lloje të sulmeve në internet ndaj gazetarëve	58
16	Rekomandime për përmirësimin e sigurisë së gazetarëve, duke vendosur në fokus mbrojtjen në internet	61
	Rekomandime afatgjata	65

SHKURTICA:

AGJPP - Akademia për gjykatës dhe prokurorë publik

PLP - Prokuroria e Lartë Publike

KEDN - Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut

SHGM - Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë¹

KP - Kodi Penal

MPB - Ministria e Punëve të Brendshme

OSBE - Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë

PPTH - Prokuroria Publike Themelore

OKB - Organizata e Kombeve të Bashkuara

Platforma - Platforma për promovim të mbrojtjes së gazetarisë dhe sigurisë së gazetarëve në kuadër të Këshillit të Evropës

RPK - Reporterë pa kufij

RMV - Republika e Maqedonisë së Veriut

KE - Këshili i Evropës

KEMM – Këshilli për Etikë në Mediat e Maqedonisë²

SPGPM – Sindikati i Pavarur i Gazetarëve dhe Punononjësve Mediatik

1 Emri i plotë i Shoqatës është: Shoqata e gazetarëve të Maqedonisë, ndërsa emri i shkurtër është SHGM; dhe e njëjta është themeluar në vitin 1946 si një shoqatë e pavarur, e mëtevjësishme, joqeveritare dhe jopartiake, me seli në Shkup, Republika e Maqedonisë së Veriut. Në pajtueshmëri me Marrëveshjen e Prespës të vitit 2018 për ndryshimin e emrit kushtetues të shtetit, çdo përmendje e termit Maqedoni në tekstin e mëtejshëm do të nënkuptojë se bëhet fjalë për Republikën e Maqedonisë së Veriut.

2 Emri i plotë i Këshillit është: Këshilli për etikë në media në Maqedoni, ndërsa emri i shkurtër është KEMM; dhe e njëjta është themeluar në vitin 2014 si një organizatë joqeveritare, jopolitike dhe jofitimprurëse me seli në Shkup, Republika e Maqedonisë së Veriut. Në pajtueshmëri me Marrëveshjen e Prespës të vitit 2018 për ndryshimin e emrit kushtetues të shtetit, çdo përmendje e termit Maqedoni në tekstin e mëtejshëm do të nënkuptojë se bëhet fjalë për Republikën e Maqedonisë së Veriut.

1

HYRJE

Siguria e gazetarëve dhe punonjësve mediatik gjatë ushtrimit të detyrave profesionale është një parakusht për gazetari të pavarur dhe kualitative. Niveli i demokracisë së një shteti varet nga cilësia e informatave, lirisë për të hulumtuar dhe raportuar për tema të ndryshme, si dhe nga liria dhe pavarësia e mediave. Sulmet ndaj gazetarëve dhe punonjësve mediatik në përgjithësi nuk janë vetëm shkelje individuale, por edhe shkelje kolektive të të drejtave të qytetarëve pasi kështu cenohet e drejta për informim, që është kategori kushtetuese në shtetin tonë.

Në mënyrë që gazetarët, respektivisht punonjësit mediatik të jenë të sigurt dhe të lirë në kryerjen e obligimeve të punës, nevojitet që shteti, respektivisht institucionet, t'i sigurojnë kushtet e nevojshme. Në këtë drejtim, shteti duhet të sigurojë një kornizë cilësore juridike, punë efikase të pushtetit ekzekutiv dhe gjyqësor, qarkullim të lirë të informacioneve nga institucionet shtetërore deri tek gazetarët dhe vazhdimisht të punojë për avancimin e lirisë së shprehjes.

Liria e shprehjes dhe siguria e gazetarëve janë tema të lidhura të pandashme. Në pesë vitet e fundit, gazetarët dhe punonjësit mediatik janë ballafaquar me sulme të shumta fizike dhe verbale, me presione nga ana e funksionarëve publik, por edhe me presione nga ana e redaksive ku punonin. Këto sulme dhe presione paraqiteshin në forma të ndryshme. Kreativiteti i

atyre që duan të bëjnë presion ndaj gazetarëve paraqitet shumë shpesh në forma të reja, ndërsa teknikat e presionit evoluojnë me një shpejtësi të madhe, dhe nëse në një shtet nuk ka drejtësi të shpejtë dhe efikase, dëmet që mund të shkaktohen nga këto sulme mund të jenë katastrofale.

Lëndë e këtij raporti do të jenë sulmet ndaj gazetarëve, si dhe shkeljet më serioze të të drejtave të punonjësve mediatik që para së gjithash janë pjesë e Regjistrimit të sulmeve në Shoqatën e Gazetarëve të Maqedonisë (SHGM), edhe atë në pesë vitet e fundit. Në pjesën e parë të analizës do të paraqitet kategorizimi i sulmeve ndaj gazetarëve dhe punonjësve mediatik. Do të analizohen në mënyrë të detajuar sulmet ndaj gazetarët nga viti 2017 deri në vitin 2021. Përveç kësaj, në mënyrë të veçantë do të analizohen sulmet ndaj gazetarëve, pasi që gjatë viteve të fundit ka një trend në rritje të sulmeve pikërisht ndaj tyre. Theks të veçantë do të kenë sulmet në internet ndaj gazetarëve, ndërsa në fund të analizës përfshihen edhe rekomandimet për avancimin apo përmirësimin e sigurisë në internet të gazetarëve dhe punonjësve mediatik.

Qëllimi i këtij raporti është që të vihen në dukje trendet në Republikën e Maqedonisë së Veriut, të cilat kontribuojnë në zvogëlimin apo rritjen e sigurisë së gazetarëve në pesë vitet e fundit, faktorët që ndikojnë në llojet e sulmeve, si dhe veprimi i institucioneve në situata dhe periudha të caktuara. Konkluzat e këtij raporti nuk kanë të bëjnë vetëm me sulmet ndaj gazetarëve, me theks të veçantë tek sulmet në internet, por ofrojnë edhe udhëzime të përgjithshme bazuar në trendet e sulmeve ndaj gazetarëve dhe punonjësve mediatik, respektivisht media-ve tradicionale dhe ato në internet.

Në mënyrë shtesë, përpilimi i këtij raporti synon të rrisë ndërgjegjësimin e publikut dhe institucioneve në drejtim të ndryshimeve në legjislacion me qëllim të përmirësimit të sigurisë fizike të gazetarëve, dhe veçanërisht në hapësirën në internet sepse hulumtimet tregojnë se sulmet në internet janë të shpeshta, të zgjeruara dhe paraqesin më shumë se gjysmën e numrit të përgjithshëm të sulmeve. Mes tjerash, qëllimi i këtij raporti është të alarmojë institucionet e sistemit për dhunën me të cilën ballafaqohen gazetarët në hapësirën e internetit, nivelin e gjuhës së urrejtjes dhe sulmet e shpeshtuara me bazë gjinore nëpërmjet rrjeteve sociale, dhe se si mund të parandalohen këto sulme, gjegjësisht të ndikohet në mënyrë parandaluese ndaj sulmuesve të mundshëm.

Praktika e deritanishme në Republikën e Maqedonisë së Verit ka treguar se Kodi Penal (KP), nuk ka ofruar mbrojtje efikase dhe të mjaftueshme, respektivisht ka krijuar një praktikë të pavolitshme në procedurat para prokurorisë kur bëhet fjalë

për sulmet ndaj gazetarëve në sferën në internet. Lidhur me sulmet ndaj gazetarëve, të njëjtat marrin edhe dimension gjinor kur ndërlidhen format e ndryshme të gjuhës së urrejtjes dhe diskriminimit. Kjo në mënyrë plotësuese rrezikon punën e gazetarëve pasi që vepra penale merr formën e saj kualifikuese (vepër më e rëndë penale) e cila ka pasoja të rënda dhe afatgjata për vetë viktimat, por edhe për proceset demokratike në mbarë shoqërinë.

Interpretimi i dispozitave të Kodit Penal nga ana e prokurorisë i lë gazetarët që vetë ta kërkojnë drejtësinë për dhunën në internet me të cilën ballafaqohen. Duke i lënë gazetarët që vetë ta kërkojnë drejtësinë, pa ndihmë të prokurorisë si paditës/përfaqësues të autorizuar të akuzës, nuk është e mjaftueshme për avancimin e sigurisë. Ky raport do të analizojë sulmet ndaj gazetarëve në pesë vitet e fundit, tendencat e sulmeve, si dhe do të ofrojë rekomandime për mbrojtje më efektive të sigurisë së gazetarëve në përgjithësi, si dhe në sferën në internet.

2

METODOLOGJIA

Raporti përfshin analizimin e raporteve të besueshme që lidhen me temën në nivel lokal dhe ndërkombëtar dhe i njejtë tenton që të bëjë një përmbledhje gjithpërfshirëse në bazë të të dhënave dytësore. Përveç kësaj, raporti jep edhe këndvështrime juridike të disa vendimeve të Prokurorisë Publike (PP), vendimeve të gjykatare në RMV, duke marrë parasysh ligjet përkatëse kombëtare si dhe ato ndërkombëtare lidhur me sigurinë e gazetarëve dhe paralajmërimet për ndryshime në KP të Republikës së Maqedonisë së Veriut.


Gjetjet në këtë raport janë marrë kryesisht nga Regjistri i sulmeve ndaj gazetarëve, të udhëhequr vetëm nga SHGM, deri më datë 11.11.2021. Ky regjistër³ në formë të përgjithshme është i qashtëm për publikun dhe në të përveç emrave dhe mbiemrave të gazetarëve mediatik, janë vendosur edhe emrat dhe mbiemrat e sulmuesëve, në rastet kur ata janë të njohur. Përveç kësaj, ky raport jep edhe detaje nëse rastet janë denoncuar në MPB, si dhe synon të informojë për progresineventual në secilin prej rasteve të evidencuara nga organet e përndjekjes.

Gjatë përpilimit të raportit janë shqyrtuar dhe indeksat e lirisë së shprehjes dhe raportet e Reporterëve pa Kufij⁴, Platformës për promovim dhe mbrojtje

3 SHGM, *Raste të shkeljes së të drejtave të gazetarëve*. Shkup: SHGM 2021 <https://znm.org.mk/povreda-na-novinari/>

4 Reporterë pa kufij <https://rsf.org/en/north-macedonia>

të gazetarisë dhe sigurisë së gazetarëve në kuadër të Këshillit të Evropës (shkurt “Platforma”)⁵, raportet e Freedom House⁶, raportet për nivelin e lirisë së mediave dhe sigurisë së gazetarëve që e publikon SHGM një herë në vit⁷, si dhe të Platformës rajonale për përfaqësim të lirisë së mediave dhe sigurisë së gazetarëve⁸ etj. SHGM, si partner dhe pjesëmarrës në “Platformën” e Këshillit të Evropës, dorëzon deri tek e njëjta raporte kur në Republikën e Maqedonisë së Veriut paraqiten raste serioze të cenimit të të drejtës së gazetarëve, sidomos kur të njëjtit janë pre e sulmeve ndaj shëndetit të tyre shpirtëror dhe trupor. Gjatë përpilimit të këtij raporti janë konsultuar edhe një numër i madh publikimesh për temën e lirisë së shprehjes dhe sigurisë së gazetarëve si nga autorë vendas ashtu edhe nga organizata joqeveritare ndërkombëtare dhe organizata politike.



Почетна - Случаи на повреда на правата на новинарите низ годините

Случаи на повреда на правата на новинарите - 2021 година

Датум	Вид на инцидент	Место	Опис на инцидент	Име и презиме на новинар	Име на медиум	Име и презиме на прекршител	Пријавено во МВР	Коментар
-------	-----------------	-------	------------------	--------------------------	---------------	-----------------------------	------------------	----------

Në mënyrë shtesë, janë analizuar dispozitat nga KP i RMV-së mbi të cilat bazohen edhe analizat e vendimeve gjyqësore dhe prokuroriale lidhur me sulmet në internet ndaj gazetarëve. Në mënyrë plotësuese janë shfrytëzuar edhe informacione statistikore të siguruara nga Prokuroria Publike Themelore⁹ lidhur me atë se sa lëndë janë formuar në këtë institucion, ku si të dëmtuar apo viktimë të veprës penale paraqiten gazetarë që kryejnë punë me interes publik.

5 Platforma e Këshillit të Evropës për promovim dhe mbrojtje të gazetarisë dhe sigurisë së gazetarëve <https://fom.coe.int/pays/detail/11709590>
6 Freedom House <https://freedomhouse.org/country/north-macedonia>
7 SHGM Raportet – [Здружение на новинари на Македонија \(znm.org.mk\)](http://znm.org.mk)
8 Platforma rajonale për përfaqësim të lirisë së mediave dhe sigurisë së gazetarëve <https://bit.ly/3FeuAhO>
9 PTHP Shkup. *Lënda:Informacioni A nr.474/21*.Shkup :PPTH 2021.

Janë konsultuar më shumë publikime që përfshijnë temën e sigurisë së gazetarëve dhe punonjësve mediatik, të publikuara nga organizata civile lokale dhe ndërkombëtare si dhe nga organizata politike ndërkombëtare dhe organizata ndërqeveritare. Janë marrë parasysh dhe janë analizuar gjithashtu kornizat aktuale ligjore lidhur me sigurinë e gazetarëve në internet dhe fizike, si dhe ndryshimet e rekomanduara dhe plotësimet në Kodin Penal në të cilat zbatohet Konventa e Stambollit, të cilën Maqedonia e Veriut e ka nënshkruar më 8 korrik të vitit 2011, dhe më pas të ratifikuar më 23 mars të vitit 2018, e cila hyri në fuqi më 1 korrik të vitit 2018.

3

KATEGORIZIM I SULMEVE NDAJ GAZETARËVE

Sulmet dhe kërcënimet ndaj gazetarëve më së shpeshti kanë të njëjtin qëllim- që të ndalojnë raportimin kritik dhe të pengojnë publikimin e informacioneve me interes publik në etër. Format e kërcënimeve dhe sulmeve ndaj gazetarëve ndryshojnë, apo thënë më mirë, evoluojnë nga viti në vit. SHGM është organizata e vetme gazetareske në Maqedoninë e Veriut e cila mban evidencë për sulmet ndaj gazetarëve dhe punonjësve mediatik në dhjetë vitet e fundit¹⁰. Sipas kategorizimit të sulmeve ndaj gazetarëve të shfrytëzuar nga SHGM për përpilimin e Regjistrit, dallohen **pesë lloje të sulmeve ndaj gazetarëve dhe punonjësve mediatik.**

KATEGORIZIM I SULMEVE NDAJ GAZETARËVE

Shkatërrim i pronës personale të gazetarëve

Sulm ndaj mediave dhe/apo organizatave mediatike

Sulm verbal ndaj mediave dhe/apo organizatave mediatike


Sulm fizik ndaj gazetarëve

Kërcënime verbale ndaj gazetarëve

¹⁰ SHGM, *Raste të shkeljes së të drejtave të gazetarëve*. Shkup: SHGM 2021 <https://znm.org.mk/povre-da-na-novinari/>

Në periudhën prej vitit 2017 deri në vitin 2021, në Regjistrin e SHGM-së janë shën-uar madje 42 sulme ndaj gazetarëve dhe punonjësve mediatik. Prej tyre, forma më e shpeshtë e kërcënimit të sigurisë së gazetarëve janë **kërcënimet verbale**. Nga gjithsej 42 raste të sulmeve ndaj gazetarëve, 25 prej tyre janë sulme verbale ndaj gazetarëve, dy janë sulme ndaj mediave/organizatave mediatike, dhe një është sulm në formë të privimit nga liria e një gazetari.

Sulme ndaj gazetarëve dhe punonjësve mediatik, periudha 2017 - 2021



Në rastet kur në rolin e kërcënuesve paraqitet publiku, në mënyrë plotësuese këto mund të ndahen në: **kërcënime për jetën dhe shëndetin e gazetarëve, kërcënime ndaj familjarëve dhe të afërmeve të tyre, si dhe ofendime ndaj vetë gazetarëve**. Nga ana tjetër, ekzistojnë raste ku bartësit e funksioneve publike paraqiten si kërcënues të gazetarëve dhe punonjësve mediatik. Në këto raste, kërcënimet ndaj gazetarëve marrin edhe forma të tjera si për shembull: **sulmet publike ndaj gazetarëve, kërcënimet me padi** (si mjet për heshtjen e gazetarëve dhe mediave) dhe **etiketimet e gazetarëve dhe mediave**. Është e rëndësishme të theksohet se sulmet verbale ndaj gazetarëve dhe punonjësve mediatik që vijnë nga ana e funksionarëve të lartë mund të shkaktojnë sulme ndaj gazetarëve të njëjtë në rrjetet sociale apo në hapësirat publike gjatë kohës kur ata ushtrojnë obligimet e tyre profesionale.¹¹

¹¹ eMagazin. Geroski: Nuk ndjehem i sigurt, më vjen keq që Zaev hyri në kësi lloj të filmit. Shkup 2019 <https://emagazin.mk/gerovski-se-chuvstvuvam-nebezbeden-zhel-mi-e-shto-zaev-vleze-vo-vakov-film/>

Sulmet fizike ndaj gazetarëve në pesë vitet e fundit paraqesin më shumë se një të tretën e numrit total të rasteve të denoncuara në Shoqatën e Gazetarëve të Maqedonisë. Në mesin e 14 rasteve të sulmeve fizike ndaj gazetarëve sigurisht që ekzistojnë disa lloje të sulmeve fizike. Nga sulmet që janë paraqitur në SHGM vërehen: **sulme ndaj gazetarëve nga ana e sigurimeve private, sulme ndaj gazetarëve nga ana e turmave, sulme ndaj gazetarëve nga ana e simpatizuesve partiak, arrestime të gazetarëve, ndërsa është vërejtur edhe një rast i kidnapimit të gazetarëve.**

Edhe një kategori poashtu e rëndësishme në Regjistrin e sulmeve ndaj gazetarëve është **sulmi ndaj mediave/apo organizatave mediatike**. Në pesë vitet e fundit janë vërejtur dy sulme ndaj mediave dhe organizatave mediatike. Ekzistojnë lloje të ndryshme të presionit dhe sulmeve ndaj gazetarëve, por dallohen format në vazhdim që gjatë periudhës së kaluar janë vërejtur në shtetin tonë:

- **dëmtim/shkatërrim i pronës private të mediave/organizatave mediatike**
- **dëmtim/shkatërrim i pajisjes profesionale për punë**
- **thyerje dhe vjedhje në hapësirat e mediave dhe organizatave mediatike**
- **inspektime që zgjasin shumë**
- **tentime për korrupsion**
- **marrje e licencave për punë, dhe të tjera.**

Të gjitha këto lloje të ndryshme të sulmeve dëshmojnë se kushtet në të cilat mbijetojnë mediat dhe organizatat mediatike në Maqedoninë e Veriut janë tejet të rënda. Duke pasur parasysh faktin se përkaj të gjitha problemeve të përmendura më lartë, mediat janë të ekspozuara në mënyrë plotësuese në tregun e vogël dhe të ngopur mediatik, dhe në këtë mënyrë mbijetesa e tyre por edhe mbijetesa e profesionit është vërtetë e vështirë. Pikërisht këto kushte të vështirësuar të punës së mediave dhe organizatave mediatike ndikojnë në vlerësimin e pluralizmit mediatik dhe lirisë së shprehjes gjatë përgatitjes së raporteve për progresin e shtetit në këtë fushë.

Kategoria e fundit e sulmeve në Regjistrin e SHGM-së është **shkatërrimi i pronës private të gazetarëve**. Në Maqedoninë e Veriut gjatë pesë viteve të fundit është vërejtur vetëm një rast i sulmeve të këtij lloji, edhe pse në të kaluarën kishte raste të **dëmtimit të makinës, vënies në flakë të makinës private të gazetarit, vjedhje të kompjuterit nga shtëpia e gazetarit, shkrim të grafitëve kërcënuese tek shtëpitë e gazetarëve etj.**

Kategorizimi i sulmeve mundëson shqyrtim më të mirë të trendit të rasteve të sul-

meve ndaj gazetarëve. Kjo, nga ana tjetër, mundëson mbledhjen e informacioneve të cilat organizatat mediatike dhe gazetareske mund t'i shfrytëzojnë për përmirësimin e kornizës ligjore me qëllim të mbrojtjes më të mirë të gazetarëve dhe punonjësve mediatik.

Sulmet ndaj gazetarëve dhe punonjësve mediatik nga viti në vit po marrin forma të tjera, **por qëllimi i sulmeve është gjithmonë i njëjti dhe i dëmshëm në mënyrë të barabartë si për demokracinë ashtu për lirinë e shprehjes.**

Përveç SHGM-së, ekzistojnë edhe disa organizata ndërkombëtare që merren me piketimin apo regjistrimin e sulmeve ndaj gazetarëve në nivel global, përfshi edhe ato të Maqedonisë së Veriut. Një pjesë e tyre janë : Platforma e Këshillit të Evropës për Siguri të Gazetarëve, Reporterët pa Kufij, si dhe Qendra Evropiane për Liri të Mediave (QELM)¹².

12 Qendra Evropiane për Lirinë e Mediave (QELM) <https://www.ecpmf.eu/>

4

RISHIKIM I SULMEVE NDAJ GAZETARËVE DHE PUNONJËSVE MEDIATIK NË VITIN 2017

Liria e mediave dhe siguria e gazetarëve në Maqedoninë e Veriut në vitin 2017 ishte në nivel tejet të ulët madje edhe në krahasim me vendet e rajonit të Ballkanit Perëndimor. Në raportin e “Freedom House” për vitin 2017¹³, theksohej se mediat në Maqedoninë e Veriut nuk janë të lira, ndërsa sipas Indeksit për lirinë e mediave të “Reporterëve pa Kufij”¹⁴, vendi gjendej në pozitën e 111-të nga gjithsej 180 shtetet e analizuara. Këto të dhëna tregojnë se në këtë periudhë nuk ishte fare e sigurt që të ushtrosh profesionin e gazetarit. Për krahasim, në vitin 2017 Maqedonia e Veriut ishte shteti i ranguar më dobët në Ballkanin Perëndimor.

Këto vlerësime negative në raportet ndërkombëtare nuk ishin të rastësishme. Sipas Regjistrimit të SHGM-së, në vitin 2017 ishin regjistruar 16 sulme ndaj gazetarëve dhe punonjësve mediatik. Prej tyre, gjashtë ishin sulme verbale ndaj gazetarëve, nëntë ishin sulme fizike ndaj gazetarëve, dhe kishte një rast të shkatërrimit të pronës private. Është me rëndësi të theksohet se jo të gjithë gazetarët vendosin që t’i paraqesin sulmet dhe kërcënimet në SHGM. Një pjesë e tyre sulmet i denoncojnë në polici, ndërsa një pjesë e tyre vendosin të mos i denoncojnë fare sulmet ndaj

13 FreedomHouse. *Raport i Freedom House për Maqedoninë e Veriut për vitin 2017*. Nju Jork : 2017, qasur më 12.11.2021. <https://freedomhouse.org/country/north-macedonia/freedom-world/2017>

14 Reporterë pa Kufij. *Indeksi i lirisë së mediave të Reporterëve pa Kufij*. Paris: 2017, qasur më 12.11.2021. <https://rsf.org/en/north-macedonia>. <https://rsf.org/en/north-macedonia>

tyre. Sipas kësaj, numri i gazetarëve dhe punonjësve mediatik të sulmuar është gjithmonë më i lartë se sa numrat me të cilat disponon MPB apo SHGM.

Në vitin 2017, konteksti politik ishte i tillë që dalëngadalë po ndryshonte pushteti në shtet, ndërsa ndryshimi ishte shumë tensionues saqë në fund rezultoi me një nga sulmet më brutale ndaj gazetarëve dhe punonjësve mediatik. Më 27 prill të vitit 2017, në Kuvendin e RMV-së, hyri me dhunë turma e cila po protestonte atë ditë. Gjatë hyrjes në Kuvend, turma e protestuesve nuk zgjidhte mjete me të cilat i sulmonte gazetarët, punonjësit mediatik dhe politikanët. Shumë gazetarë dhe punonjës mediatik ishin lënduar dhe luftonin për jetën e tyre para syve të mbarë opinionit publik në Maqedoninë e Veriut. Sulmuesit i përdornin pajisjet e gazetarëve si armë me të cilat keqtrajtonin dhe rrihnin gazetarët që ishin prezent. Kjo ditë do të mbetet mend si “e enjtja e përgjakshme”.

Atë ditë në Kuvend ishin sulmuar më shumë se 20 gazetarë dhe punonjës mediatik. Kjo paraqet edhe numrin më të madh të gazetarëve të sulmuar në pesë vitet e fundit, pasi në fakt, në vitin 2017 janë regjistruar më së shumti sulme ndaj gazetarëve të Maqedonisë së Veriut në pesë vitet e fundit. Më shumë se katër nga gazetarët e sulmuar kanë qenë gazetarë që atë ditë po raportonin nga Kuvendi, ndërsa njëra prej tyre ishte sulmuar edhe pse ishte shtatzënë. Sipas dëshmimeve¹⁵ të gazetarëve që kanë qenë në Parlament gjatë të “enjtjes së përgjakshme”, turma i ka goditur, ofenduar, kërcënuar dhe madje ua ka fshirë video materialet nga kamerat dhe celularët e tyre.


Deri në mesin e vitit 2017, Maqedonia e Veriut ishte i vetmi shtet në rajon që kishte gazetar që vuante dënim efektiv me burg për shkak të një teksti të shkruar dhe publikuar. Gazetari Zoran Bozhinovski ishte mbajtur në paraburgim për një vit e gjysmë pas ekstradimit të paligjshëm nga Serbia në prill të vitit 2016. Ai ishte i dyshuar për vepra penale që lidhen me spiunim, bashkim kriminel dhe shantazh. Kah mesi i korrikut të vitit 2017, tre ditë para skadimit të afatit ligjor për mbajtje në paraburgim, Bozhinovski ishte lëshuar që të mbrohet në liri. Ky vendim nuk ishte për shkak të vullnetit të mirë të gjykatës, por për shkak të mungesës së rrethanave ligjore që gazetarit t'i vazhdohet paraburgimi.

Sot, thuhet pesë vite më pas, mund të bëhet një përkufizim lidhur me atë se si shteti dhe institucionet i trajtojnë apo i kanë trajtuar sulmet ndaj gazetarëve. Lënda e gaze-

15 Mrgja, D. Murtezi, E. Bellavska, K. “Sulmet ndaj gazetarëve dhe punonjësve mediatik më 27 prill të vitit 2017” Shkup : SHGM 2021, 3-11.

tarit Zoran Bozhinovski është kthyer përsëri në gjykim, asnjë prej sulmuesve të gazetarëve (nga viti 2017) nuk është dënuar nga gjykata, ndërsa Gjykata Themelore Civile në Shkup i ka refuzuar kërkesat nëpërmjet padive të gazetarëve për “të enjten e përgjakshme” për kompensim të dëmit jomaterial. Ndërkohë, të vetmit që panë drejtësi për ngjarjet e 27 prillit janë politikanët. Sulmuesit e tyre tashmë janë të dënuar. Kjo flet për standardet e dyfishta gjatë trajtimit të lëndëve të sulmeve ndaj gazetarëve dhe punonjësve mediatik për dallim prej atyre të politikanëve, si dhe për nivelin e lartë të mosndëshkimit të sulmeve ndaj gazetarëve.¹⁶

Shqyrtim i sulmeve ndaj gazetarëve në vitin 2017



16 SHGM, SPGPM. SHGM dhe SPGPM: *Drejtësia selektive për 27 orillin është ofendim për qytetarët dhe gazetarët. Shkup 2021, qasur më 13.11.2021 - <https://bit.ly/3rbc2sR>*

5

RISHIKIM I SULMEVE NDAJ GAZETARËVE DHE PUNONJËSVE MEDIATIK NË VITIN 2018

Në vitin 2018, SHGM ka regjistruar gjithsej tre raste të sulmeve ndaj gazetarëve. Sipas numrit të sulmeve, viti 2018 është viti në të cilin janë regjistruar më së paku sulme që kur mbahet evidenca për numrin e të njëjtëve. Megjithatë, numri i vogël i sulmeve nuk do të thotë edhe reagim i shpejtë dhe efikas i institucioneve kompetente për t'i zbardhur të njëjtat. Si dëshmi se mungonin shumë elemente për përmirësimin e gjendjes mediatike në shtet flet edhe fakti se në vitin 2018, sipas Indeksit të lirisë së mediave në “Reporterët pa Kufij”, vendi ka përpunuar vetëm për dy vende, respektivisht u gjend në vendin e 109-të në nivel botëror.

Nga tre sulmet e regjistruara në vitin 2018, SHGM ka vërejtur një sulm verbal, një fizik dhe një rast arrestimi të gazetarit. Numri i vogël i sulmeve nuk do të thotë se rastet e regjistruara nuk janë serioze. Përkundrazi, të trija sulmet ishin tejet serioze ndaj gazetarëve dhe lirisë së shprehjes.

Sulmi fizik ndodhi ndaj Armand Brahos, i cili ishte sulmuar gjatë konferencës së partisë Aleanca për Shqipëtarët (ASH) në Strugë. Sipas gazetarit Braho, disa persona nga partia Aleanca për Shqipëtarët e kanë keqtrajtuar dhe penguar që ta përcjellë konferencën drejtpërdrejt, ndërsa pas përfundimit të ngjarjes e kanë sulmuar gazetarin edhe

fizikisht. Në këtë rast institucionet dhe policia reagueshpejtë dhe sulmuesit u dënuan me kusht.¹⁷

Rasti i dytë i sulmit ndaj gazetarëve ishte regjistruar në mars të vitit 2018, kur vëllai i një funksionari të lartë në Bashkimin Demokratik për Integrim i dërgoi kërcënim me vdekje kryetarit të SHGM-së Naser Selmani. Rasti ishte denoncuar në polici, ndërsa pas reagimeve të vrullshme të opinionit, Prokuroria Themelore Publike (PTHP) hapi lëndë për këtë rast. Megjithatë, përkundër faktit se këto kërcënime ishin dënuar edhe nga faktori ndërkombëtar, dhe përkundër protestës¹⁸ që u mbajt para Qeverisë së RMV-së, PTHP deri në këtë moment nuk ka ngritur ndonjë akuzë kundër personit që dërgoi kërcënime me vdekje në adresë të gazetarit Selmani.

Në rastin e tretë dhe të fundit ishte përfshirë policia. Në këtë rast, gazetari i “Infomaks”-it, Borisllav Stoillkoviç ishte arrestuar për gjoja kundërshtim që të lejjitimohet gjatë incizimit dhe raportimit nga një protestë. Është me rëndësi të theksohet se gjatë shqyrtimit të incizimeve ishte e qartë se gazetari Stoillkoviç mbante identifikimin e gazetarit në vend të dukshëm, në qafë.¹⁹

Numri i vogël i sulmeve në vitin 2018 ishte një mundësi shumë e mirë që MPB, PTHP dhe gjykatat kompetente në shtet të zbardhin të paktën disa prej rasteve që kishin ndodhur gjatë viteve të kaluara. Megjithatë, institucionet nuk e shfrytëzuan këtë mundësi dhe mosndëshkimi i sulmeve ndaj gazetarëve vazhdoi të jetë një nga indikatorët kryesorë për nivelin e sigurisë së gazetarëve.

Numri i sulmeve ndaj gazetarëve dhe punonjësve mediatik në Maqedoninë e Veriut shumë shpesh varet nga situata politike në shtet. Për shembull, më së shpeshti regjistrohet rritje e numrit të sulmeve ndaj gazetarëve dhe punonjësve mediatik në vitet kur mbahen zgjedhje lokale apo parlamentare.. Jo rrallë herë, politikanët i etiketojnë gazetarët gjatë fushatës apo i ofendojnë, ndërsa simpatizuesit partiak më pas këtë e vazhdojnë me ofendime, kërcënime apo sulme ndaj gazetarëve.²⁰ Një nga arsyt kryesore përse në vitin 2018 nuk kishte numër të madh sulmesh të regjistruara është pikërisht fakti se në shtet nuk kishte zgjedhje.


17 Makfaks. *Një gazetar në Strugë është sulmuar. SHGM kërkon që të dënohen sulmuesit.* Shkup : 26 janar, 2018. Qasur më 13.02.2021 <https://bit.ly/3BjwZ9Z17>

18 BG /Makfaks, Dojçe Vele. *Protestë e gazetarëve para Qeverisë.* Shkup : Viti 2018. Qasur më 13.11.2021 <https://bit.ly/3Ei4V7y>

19 Netpres. *MPB ende pa përgjigje përse është arrestuar gazetari Stoillkoviç.* Shkup, 18 korrik 2018. Qasur më 13.02.2022 <https://bit.ly/34xZWTE>

20 SHGM. *SHGM: Rritet numri i sulmeve ndaj gazetarëve, kërkojmë reagim urgjent të institucioneve kompetente.* Shkup, 22 tetor 2021. <https://bit.ly/3oL0LiG>

Rishikim i sulmeve ndaj gazetarëve në vitin 2018



6

RISHIKIM I SULMEVE NDAJ GAZETARËVE DHE PUNONJËSVE MEDIATIK NË VITIN 2019

Siguria e gazetarëve në vitin 2019 ishte në nivel të ngjashëm sikur vitin paraprak. Në Indeksin për Lirinë e Mediave të “Reporterëve pa Kufij”, Maqedonia e Veriut regjistroi një ngritje prej 14 vendesh në krahasim me vitin 2018 dhe u vendos në pozitën e 95-të.

Megjithatë, në Raportin e “Reporterëve pa Kufij” për vitin 2019 për Maqedoninë e Veriut ishte theksuar se *“Për fat të keq, përfaqësues të lartë të pushtetit kanë tendencë që të kërcënojnë dhe ofendojnë gazetarë. Kultura e mosndëshkimit ka lëshuar rrënjë dhe paraqet akoma pengesë për sigurinë e gazetarëve”*²¹

Në raportin vjetor të SHGM-së për vitin 2019 lidhur me treguesit për nivelin e lirisë së mediave dhe sigurinë e gazetarëve, janë regjistruar katër raste më serioze të sulmeve ndaj gazetarëve, por edhe rreth 20 incidente të tjera më të vogla dhe kërcënime²². Nga katër rastete paraqitura në vitin 2019, në tre raste bëhej fjalë për sulme verbale ndaj gazetarëve, ndërsa në një rast kishte sulm fizik. Është interesante se në dy rastet e përmendura kërcënimet ndaj gazetarëve i kishte bërë një biznesmen i njohur. Një prej kërcënimeve ishte dërguar në formë të porosisë me zë ku gazetares së Laboratorisë për Gazetari Hulumtuese Maja Jovanovska i është dërguar tingulli i një bom-


21 EWB. *Reporters Without Borders: North Macedonia surpasses Serbia on media freedom index*. Париз 2020. Qasur më 14.11.2021 <https://bit.ly/3GIFDWS>

22 Sekullovski, D. Sulejman, D. *“Tregues për nivelin e lirisë së mediave dhe sigurisë së gazetarëve për vitin 2019”* Shkup 2020, 28.

be duke eksploduar. Policia refuzoi që ta hetojë rastin pasi që gazetarja nuk e kishte paraqitur rastin në stacion policor, ndërsa Prokuroria Publike nuk veproi në bazë të informacioneve.

Megjithatë, rasti më serioz nga këto tre sulme në vitin 2019 ishte sulmi verbal ndaj ekipit të TV21 në Komunën e Haraçinës. Ky sulm kishte elemente të privimit të paligjshëm nga liria për çka ishin publikuar edhe audio dhe video incizime nga ana e medias. Rasti zyrtarisht nuk ishte denoncuar në MPB, dhe për këtë shkak policia pohonte se nuk mund të ngrisë procedurë. SHGM disa herë reagoi duke theksuar se për shkak të natyrës së veprës, Prokuroria vetë duhet të ndërmerr veprime sipas detyrës zyrtare. Në fund, rasti nuk mori asnjë epilog edhe përkundër faktit që kryetarja e komunës së Haraçinës Milikije Halimi kërkoi falje publike për incidentin, duke konfirmuar se i njëjti ka ndodhur në të vërtetë.

Rishikim i sulmeve ndaj gazetarëve në vitin 2019



7

RISHIKIM I SULMEVE NDAJ GAZETARËVE DHE PUNONJËSVE MEDIATIK NË VITIN 2020

Në vitin 2020, në Maqedoninë e Veriut u mbajtën zgjedhje të parakohshme parlamentare. Si zakonisht, narativi në diskursin publik ishte nxehur thuajse që nga fillimii vitit, dhe kjo padyshim kontribuoi në rritjen e tensioneve në debatet politike në të gjitha platformat, gjë që rriti edhe numrin e sulmeve ndaj gazetarëve dhe punonjësve mediatik. Për dallim nga dy vitet e mëparshme (viti 2018 dhe 2019), në vitin 2020 numri i sulmeve të regjistruara ndaj gazetarëve ishte dy shifror.

SHGM në vitin 2020 ka regjistruar 12 kërcënime ndaj gazetarëve, një sulm fizik dhe një sulm ndaj medias. Këto përbëjnë gjithsej 14 sulme të shënzuara në Regjistrin e sulmeve ndaj gazetarëve dhe punonjësve mediatik.

Në indeksin e lirisë së mediave të “Reporterëve pa kufij” për vitin 2020²³ Republika e Maqedonisë së Veriut ka shënzuar rritje për tre vende duke u vendosur në pozitën e 92-të. Është me rëndësi të theksohet se ky përparim i vogël nuk është për shkak të përmirësimit të atmosferës së punës për gazetarët në shtet, por më tepër për shkak të përkeqësimit apo regresit të disa shteteve tjera. Në këtë kontekst, në Raportin e SHGM-së për lirinë e mediave dhe sigurinë e gazetarëve për vitin 2020²⁴ theksohet se: “Në drejtim të punës së institucioneve dhe zbardhjes së sulmeve ndaj gaze-


23 RBG “Indeksi i lirisë së mediave tek Reporterët pa Kufij”, Shkup : 2021. Qasur më 15.11.2021. <https://rsf.org/en/north-macedonia>

24 Spirovski, M. Todorovska-Kostovska, V. “Tregues për nivelin e lirisë së mediave dhe sigurisë së gazetarëve për vitin 2020”. Shkup: SHGM 2020, 32.

tarëve, ekziston një moskoordinim dhe dobësi në komunikimin ndërinstitutional, ndërsa kjo është më e dukshme ndërmjet MPB-së dhe PPTH-së. Kjo ndikon që lëndët, respektivisht hetimet, të zgjasin më shumë, madje edhe kur bëhet fjalë për lëndë të qarta që mund të dëshmohen shumë lehtë.

Rastet në të cilat janë sulmuar gazetarët akoma shumë rëndë arrijnë deri tek epilogu gjyqësor, ndërsa rrallëherë arrihet deri tek nxitësit. **Mosndëshkimi ndaj autorëve mbetet i lartë, ndërsa epilog gjyqësor është konstatuar në më pak se 10 për qind të rasteve të regjistruara.**”

Rishikim i sulmeve ndaj gazetarëve në vitin 2020




Duke analizuar sulmet ndaj gazetarëve dhe punonjësve mediatik në vitin 2020, është e qartë se numri i **sulmeve verbale ndaj gazetarëve është rritur në mënyrë të konsiderueshme**. Në mënyrë shtesë, mund të vërehet se shumica e këtyre sulmeve verbale janë bërë në rrjetet sociale apo nëpërmjet mjeteve tjera të komunikimit.

Kjo tendencë kryesisht është **për shkak të pandemisë me virusin Kovid-19** e cila e kaploi shtetin, por edhe botën. Në kushte të pandemisë, masat e krizës impononin që të punohet nga shtëpia, si dhe karantinë disa ditore, shmangie të kontakteve me njerëz, e të tjerë. E gjithë kjo kontribuoi që njerëzit t'i ndryshojnë

shprehitë e tyre dhe të kalojnë më shumë kohë në botën në internet, të bëhen më të padurimshëm, ndërsa shpesh publikimin e informacioneve lidhur me masat e pandemisë një pjesë e përdoruesve e kërkonin tek ata që i përcjellin lajmet, respektivisht gazetarët.

Një dukuri tjetër më shqetësuese është numri i sulmeve ndaj gazetarëve në vitin 2020. **Nga gjithsej 14 sulme të regjistruara ndaj gazetarëve në Maqedoninë e Veriut, në nëntë raste viktima të sulmit ishin gazetarët.**

Rishikim i sulmeve ndaj gazetarëve në vitin 2020 sipas gjinisë



Sulmi i parë që paraqet një prej sulmeve më serioze verbale në vitin 2020, ishte regjistruar në fillim të muajit janar. Autor i veprës është Emil Jakimovski – nëpunës shtetëror i punësuar në Regjistrin Qendror. Jakimovski në disa raste nëpërmjet aplikacionit mobil “Telegram” ka drejtuar kërcënime serioze verbale ndaj gazetares Meri Jordanovska. Në mesazhet që i ka dërguar Jordanovskës ka pasur një mori ofendimesh, shpifjesh, por edhe kërcënim për jetë. Jakimovski nuk është ndalur këtu me kërcënimet ndaj gazetarëve. Vetëm pak ditë më vonë, mesazhe me përmbajtje të ngjashme iu dërguan edhe gazetares Iskra Koroveshovska. Të dy rastet u denoncuan në polici si dhe në Shoqatën e Gazetarëve të Maqedonisë. Serioziteti i kërcënimeve nxiti reagime të shumta në opinion dhe me këtë

institucionet u vënë nën presion, ndërsa kërcënuesit iu shqiptua dënim me burg prej 20 muajsh²⁵.

Këto sulme ishin vetëm hapje e asaj që vazhdoi më tej. Pesë gazetarë të tjerë, të gjitha nga media të ndryshme, morrën kërcënime me jetë për shkak të mënyrës se si kanë raportuar për ngjarje të caktuara politike, ndërsa njëra prej tyre është sulmuar gjatë raportimit në terren.

Nga ana tjetër, sulmet dhe kërcënimet me jetë nuk u ndalën as ndaj gazetarëve meshkuj dhe punonjësve mediatik, ndërsa vazhdoi edhe trendi ku figura të larta politike kërcënonin dhe etiketonin gazetarë.²⁶

Përfat të keq, në vitin 2020 vetëm sulmi i parë mori reagim adekuat nga institucionet kompetente dhe përfundoi me verdikt gjyqësor. Të gjitha sulmet e tjerë mbetën të paproceduara, ndërsa sulmuesit mbetën të pandëshkuar. Angazhimi dhe reagimi i pamjaftueshëm i institucioneve gjyqësore për t'i zbardhur këto raste, ndikoi shumë në inkurajimin e njerëzve për të kërcënuar dhe sulmuar gazetarët në të ardhmen. Mosndëshkimi nuk mund të sjellë asgjë pozitive për gazetarinë dhe as për shtetin në planin afatgjatë. Kjo mund vetëm të kontribuojë që në të ardhmen të vazhdojnë sulmet e ngjashme, që gazetaria të bëhet profesion jotërheqës, dhe cilësia e informacioneve të shënojë rënie të vazhdueshme.

25 Makfaks. *Emil Jakimovski është dënuar me një vit e tetë muaj burg*. Shkup : 2021 . Qasur më 16.11.2021 <https://bit.ly/3x-PFjMA>

26 SHGM, *Dënim i etiketimeve publike të Aleancës për Shqiptarët ndaj TV21*. Shkup : 2020. Qasur më 16.11.2021 <https://znm.org.mk/osuda-za-javnite-etiketirana-na-alija/>

8

RISHIKIM I SULMEVE NDAJ GAZETARËVE DHE PUNONJËSVE MEDIATIK NË VITIN 2021

Sulmet dhe kërcënimet ndaj gazetarëve nuk u ndalën as gjatë vitit 2021. Numri i sulmeve ka pësuar rënie në krahasim me vitin 2020, por megjithatë ekzistojnë trende tjera të reja që shkaktojnë shqetësim në fushën e gazetarisë.

Nga fillimi i vitit (deri në muajin nëntor), SHGM ka regjistruar gjithsej pesë sulme. Prej këtyre pesë sulmeve, katër ishin kërcënime verbale ndërsa një ishte sulm fizik. Ajo që shqetëson është se **edhe në vitin 2021 shumica e këtyre sulmeve (3) ishin drejtuar ndaj gazetarëve femra, gjë që paraqet një vazhdimësi të kësaj dukurie negative që ishte vërrejtur në vitin 2020, që nënkupton se numri i sulmeve ndaj gazetarëve është më i lartë se sa numri i sulmeve ndaj gazetarëve meshkuj.**

Interesante është se në tre sulmet verbale ndaj gazetarëve në vitin 2021, **kërcënimet vinin nga figura politike.**²⁷ Kjo flet për kulturën e ulët të komunikimit publik në relacionin bartës i funksionit publik – gazetar, por flet edhe për atë se bartësit e funksioneve publike në Maqedoninë e Veriut shumë lehtë marrin guximin që të kërcënojnë gazetarët.

Është me rëndësi të theksohet se **MPB apo PPTH nuk kanë hapur lëndë për asnjërën nga këto tri raste, edhe pse kërcënimet ishin denoncuar në polici.**

²⁷ SHGM, *Raste të shkeljes së të drejtës së gazetarëve*. Shkup: SHGM 2021. Qasur më 11.11.2021 <https://znm.org.mk/povreda-na-novinari/>

Megjithatë, njëri nga sulmete regjistruara si sulm ndaj një grupi më të madh të gazetarëve ishte proceduar nga policia. Në mesin e qershorit, MPB informoi²⁸ se ka ngritur kallëzim penal kundër një personi i cili në rrjetet sociale ka drejtuar kërcënime verbale me jetë ndaj më shumë gazetarëve. Deri në këtë moment të përgatitjes së këtij raporti, nuk ka informacion nëse prokuroria ka kryer hetim për këtë rast apo nëse është ngritur kallëzim deri tek gjykata kompetente.

Mosveprimi i institucioneve dhe zvarritja e procedurave mund të shkaktojë “efekt ftohës” tek gazetarët, që nënkupton dekurajimin e ushtrimit legjitim të të drejtave natyrore dhe ligjore për shkak të kërcënimit nga sanksioni juridik, dhe në kontekst të gazetarisë ky efekt paraqet vetë-censurë nga frika e pasojave.

28 SHGM. SHGM. *Është gjë pozitive që MPB veprimi, presim epilog gjyqësor për kërcënimet ndaj gazetarëve*. Shkup: Viti 2021. Qasur më 12.11.2021 <https://bit.ly/3Dm8Zll>

9

TRENDE TË SULMEVE NDAJ GAZETARËVE GJATË PERIUDHËS JANAR 2017 – NËNTOR 2021

Numri i sulmeve ndaj gazetarëve në pesë vitet e fundit ka pasur luhajtje. Shpeshtimi i tyre dhe lloji i sulmeve shpesh lidhen me kontekstin shoqëror, rajonal, e ndonjëherë edhe atë global, apo momentin politik. Nëpërmjet analizës së sulmeve mund të nxirren disa konkluzë më të rëndësishme lidhur me trendet e sulmeve ndaj gazetarëve.

Konkluzë e parë është se gjatë dy viteve të fundit, numri i sulmeve ndaj gazetarëve dominon në krahasim me sulmet ndaj gazetarëve meshkuj. Shpesh në kërcënimet dhe ofendimet që drejtohen kah gazetarët dhe punonjëset mediatike, përdoret gjuhë seksiste që jep karakteristikë plotësuese se këto sulme nuk kanë të bëjnë vetëm me punën e gazetarëve, por se ato bazohen edhe në gjini.

Konkluzë e dytë me rëndësi në kontekst të sigurisë së gazetarëve dhe shpeshtimit të sulmeve ndaj tyre është se në situata turbulente politike, e sidomos gjatë periudhës së zgjedhjeve, numri i sulmeve dhe kërcënimeve ndaj gazetarëve rritet. Ndaj kësaj dukurie në mënyrë të konsiderueshme ndikojnë edhe etiketimet e shpeshta dhe sulmet verbale nga ana e politikanëve. Kjo sjellje i inkurajon simpatizuesit partiak që të ndjekin shembullin e tyre dhe të vazhdojnë me të njëjtin stil të kërcënimit ndaj gazetarëve dhe punonjësve mediatik.

Konkluzat e tretë që buron nga analiza e sulmeve në pesë vitet e fundit, është se në kushte pandemie sulmet fizike janë zvogëluar, ndërsa numri i kërcënimeve në internet ndaj gazetarëve ka shënuar një rritje të konsiderueshme.


Në rritjen e kërcënimeve në internet ndaj gazetarëve kontribuon edhe mosinformimi i publikut apo opinionit lidhur me atë se ku janë kufijtë e lirisë së shprehjes dhe kur ajo që shkruajnë apo komentojnë kalon në gjuhë të urrejtjes apo kërcënim verbal.

Trendi i katër dhe kushtimisht thënë, trendi më me rëndësi që po vazhdon gjatë dhjetë viteve të fundit, është trendi i mosndëshkimit të sulmeve ndaj gazetarëve. Edhe përkundër raporteve të shumta vendore dhe ndërkombëtare që flasin për këtë problem, edhe përkundër konferencave që përdoren për të folur për këtë çështje, edhe përkundër analizave të shumta lidhur me këtë temë, mosndëshkimi vazhdon të lulëzojë dhe të përdoret si shembull negativ në nivel botëror.

Viti	Gjendja në shtet	Numri i sulmeve të regjistruara
2017	Zgjedhjet parlamentare	16
2018	Organizimi i referendumit	3
2019	Zgjedhjet presidenciale	24
2020	Pandemia dhe zgjedhjet parlamentare	14
2021	Pandemia dhe zgjedhjet lokale	5

Në grafikun më poshtë tregohet numri i sulmeve ndaj gazetarëve sipas gjinisë së tyre, gjatë pesë viteve të fundit.

Rishikim i sulmeve ndaj gazetarëve dhe punonjësve mediatik në pesë vitet e fundit



10

SULME NË INTERNET NDAJ GAZETAREVE

Çdo lloj i mjedisit armiqësor në aspekt gjinor është sulm direkt ndaj lirisë së shprehjes me qëllim që të heshten zërat e femrave dhe storiet që ata tregojnë, apo duhet t'i tregojnë. Gazetarët janë vazhdimisht pre e sulmeve me gjuhë të urrejtjes si në nivel lokal ashtu edhe në nivel global dhe qëllimi final është sigurisht heshtja e tyre. Por, nëse cak i këtyre sulmeve janë gazetarët femra, atëherë gjuha e urrejtjes merr specifika tjera pasi që sulmet e tilla marrin dimension gjinor.

Nëse gjuha e urrejtjes drejtuar ndaj gazetaresve nuk dënohet apo nëse nuk kërkohet llogari nga institucionet që veprojnë, mund të ketë pasoja të thella tek e gjithë shoqëria në tërësi. Gazetarët e ekspozuara ndaj sulmeve në internet për shkak të profesionit dhe gjinisë së tyre, janë nën rrezik të madh të cenimit të shëndetit të tyre trupor dhe mendor, nderit, imazhit dhe dinjitetit. Po ashtu, ato janë nën rrezik të cenimit të privatësisë dhe jetës personale familjare, si dhe janë të ekspozuar ndaj torturës psikike dhe në disa raste stigmatizimit nga mjedisi ku jetojnë.

Këto trende më pas sjellin deri tek i ashtuquajtimi “efekt ftohës” ku gazetarët femra vetë-censurohen nga të folurit e mëtejme, hulumtimit mbi tema të caktuara apo në raste ekstreme një gjë e tillë shkakton tërheqje të tërësishme nga profesioni i gazetarisë. Ky frenim në mënyrë shtesë nxitet nga

mosveprimi i institucioneve apo efikasiteti i dobët gjatë zhvillimit të hetimeve dhe mbledhjes së provave. MPB si mjet në duart e prokurorisë është institucioni i vetëm me qasje tek mekanizmat për mbledhje të provave në sferën në internet ku nevojitet gjetja e sulmuesve nëpërmjet IP adresave dhe ngjashëm. Megjithatë, duhet të theksohet se vendimin final nëse do të ngritet procedurë penale kundër sulmuesve e merr prokuroria publike.

Sulmet ndaj gazetarëve nëpërmjet platformave në internet doemos duhet ta nderojnë alarmin tek institucionet pasi që jeta në epokën digjitale i ka bërë sulmuesit më të guximshëm, më me vetëbesim dhe më të ashpër në sulmet e tyre. Sulmet ndaj gazetarëve po marrin edhe kontekst gjinor, andaj edhe sulmuesit i konsiderojnë si viktime “të lehta” dhe janë pa frikë nga pasojat apo dënimi. Në mënyrë shtesë, sulmet në sferën në internet po përforcohen për shkak se sulmuesi nuk ballafaqohet me viktimitë ndërsa në shumicën e rasteve sulmet vijnë nga profile anonime apo të ashtuquajtura “bote”²⁹ që përdorin “VPN”(Virtual Private Network), të ashtuquajtura rrjete private, kështu që me lehtësi mund ta fshehin gjurmën e vet në sferën në internet, dhe për këtë shkak edhe institucionet kompetente e kanë më të vështirë që t’i gjejnë.

Praktika ka dëshmuar se procedura për gjetjen e sulmuesve që përdorin platforma të internetit është e rëndë dhe e ngadalshme, dhe e njëjta kërkon bashkëpunim ndërinstytucional dhe poashtu duhet që institucionet vendore – organet e përndjekjes që të drejtohen jashtë shtetit me anë të instrumenteve për ndihmë ndërkombëtare juridike për të mbledhur informacione në procedurën parahetimore, edhe atë nëpërmjet ministrisë adekuate.

Hallka e parë dhe themelore në “zinxhirin” e mbrojtjes së sigurisë së gazetarëve sigurisht që është MPB-ja, respektivisht Sektori për krim kompjuterik dhe forenzikë digjitale i cili pas dorëzimit të denoncimit me shkrim apo nëpërmjet postës elektronike: : cybercrime@moi.gov.mk ngre procedurë për mbledhjen e informacioneve dhe identifikimin, dhe i njëjti këto të dhëna, prova, i dërgon në prokurorinë kompetente e cila vendosë nëse do të vazhdojë me procedurën apo do ta refuzojë denoncimin.

Duhet që të bëhet apel deri tek Sektori për krim kompjuterik dhe forenzikë digjitale pranë MPB-së që të veprojë shpejtë, në mënyrë transparente dhe efikase në

29 Oxford Learner’s Dictionaries. 1.Program kompjuterik i cili punon me detyra të automatizuara nëpërmjet internetit. 2.Program kompjuterik që krijon profile të rrejshme në rrjetet sociale dhe komunikon me përdoruesit e tjerë. Qasur më 02.12.2021 . <https://www.oxfordlearnersdictionaries.com/definition/english/bot?q=bots>

rastet kur bëhet fjalë për kërcënim në internet të sigurisë së gazetarëve dhe sigurisht edhe gjithë qytetarëve, sikurse kur vepron kur janë në pyetje funksionarët publik.

Shembull për këtë është shpejtësia e veprimit të MPB-së, respektivisht dorëzimit të kallëzimit penal kundër "...M.N (61) nga Shkupi, për shkak të publikimit të një komenti në rrjetin social Facebook me të cilin shkaktohet kërcënim i sigurisë së kryetarit të Qeverisë së Maqedonisë së Veriut" dhe edhe vetë Ministria bën thirrje nëpërmjet komunikatave publike që "qytetarët që janë të ekspozuar ndaj kërcënimeve nëpërmjet hapësirës së internetit, sidomos për vepra penale sipas nenit 144 "kërcënim i sigurisë" dhe sipas nenit 394-g "shpërndarja e materialit racist dhe ksenofobik nëpërmjet sistemit kompjuterik" nga Kodi Penal i Maqedonisë së Veriut, që t'i denoncojnë në stacionin më të afërt policor apo në adresën elektronike cybercrime@moi.gov.mk.³⁰

Përkundër veprimit të këtillë ku menjëherë është gjetur personi që gjoja e ka kërcënuar sigurinë e kryetarit të Qeverisë së Maqedonisë së Veriut, një numër i caktuar i lëndëve të sulmeve në internet ndaj gazetarëve, akoma janë pa epilog, respektivisht hetimi për gjetjen e autorëve rrjedh me vështirësi. Megjithatë, duhet theksuar se secili rast është i veçantë dhe me rrethana të ndryshme. Shpresojmë që ky Sektor pranë MPB-së në të ardhmen t'i kryejë edhe më mirë detyrat në përputhje me kompetencat ligjore dhe të investojë në personel dhe pajisje teknike.

30 MPB. Kallëzim penal për kërcënim të sigurisë dhe shpërndarje të materialit ksenofobik dhe racist nëpërmjet sistemit kompjuterik. Shkup: 2018. Qasur më 02.12.2021 <https://mvr.gov.mk/vest/7644>

11

DITA NDËRKOMBËTARE PËR LUFTË KUNDËR DHUNËS NDAJ GRAVE NËPËRMJET PRIZMIT TË KOMBEVE TË BASHKUARA

“Gjashtëmbëdhjetë ditë akzivëm kundër dhunës së bazuar në gjini” është fushatë vjetore ndërkombëtare, e cila fillon me 25 nëntor, datë kjo në të cilën shënohet Dita ndërkombëtare për luftë kundër dhunës ndaj grave. Me rastin e shënimit të kësaj dite, dhe me mbështetjen e UNESCO-s, Raportuesja Speciale e Kombeve të Bashkuara për lirinë e mendimit dhe shprehjes përgatiti publikimin “#JournalistsToo – Women Journalists Speak Out” apo në përkthim “Gazetarët Gjithashtu – Gazetarët Femra Ngrisin Zërin”. Publikimi përfshin deklaratë të 11 gazetareve nga e gjithë bota, të cilat ndajnë përvojat e tyre personale për dhunën e bazuar në gjini dhe kërcënimet që kanë marrë gjatë ushtrimit të profesionit të tyre. Përmbledhja e këtyre rrëfimeve tregon se si funksionon keqpërdorimi dhe si format e ndryshme të diskriminimit përputhen, për çka edhe shumë gazetarë ballafaqohen me homofobi, racizëm apo diskriminim bazuar në religjion, përpos dhunës së bazuar në gjini në të cilën tashmë janë të ekspozuara.³¹

Raportuesja Speciale për lirinë e shprehjes në kuadër të OKB-së Ajrin Kan, mes tjerash deklaroi:

“Përderisa gazetarët meshkuj edhe femra janë të ekspozuar ndaj dhunës dhe kërcënimit të sigurisë së tyre për

31 UNCHR. #JournalistsToo – Women Journalists Speak Out. Hyjopk 2021. Qasur më 04.12.2021 <https://sr-freedex.org/journalists-too/>

shkak të punës që bëjnë, sulmet ndaj femrave janë të bazuara në gjini dhe janë të seksualizuara si në internet ashtu edhe jashtë tij”. Raportuesja Speciale e OKB-së për lirinë e shprehjes theksoi se sulmet ndaj gazetareve kanë për qëllim frikësimin, heshtjen, dhe tërheqjen e tyre nga pjesëmarrja në jetën publike, dhe kjo përbën një shkelje eklatante të lirisë së shprehjes dhe të drejtës për pjesëmarrje në jetën publike. Raportuesja Speciale për OKB-në më tej thotë se: “Nevojitet veprim urgjent nga të gjithë aktorët dhe në të gjitha nivelet për t’iu përgjigjur mosmëndshkimit, seksizmit dhe mizogjenisë nëpërmjet të cilave po lulëzon dhuna ndaj gazetareve”.³²

Në të njëjtën kumtesë të Kombeve të Bashkuara me rastin e 25 nëntorit, ekspertja e pavarur bëri thirrje deri tek qeveritë që të krijojnë mekanizma efektiv për parandalim, mbrojtje, mbikëqyrje dhe përgjigje adekuate për sigurinë në internet dhe fizike të gazetareve femra. Ndërkohë ka shtuar se: **kompanitë që menaxhojnë me rrjetet sociale duhet t’i bëjnë hapësirat digjitale të sigurta për femrat, mediat duhet të kenë zero tolerancë për dhunën e bazuar në gjini dhe shqetësimin në vendin e punës, dhe u bëj thirrje politikanëve dhe liderëve që të dënojnë sulmet ndaj gazetareve femra dhe të përmbahen nga deklaratat që do t’i fusnin ato në rrezik.**

“Nuk mund të pranojmë që të heshten femrat sepse raportimi i tyre është i pakëndshëm për dikë, apo sepse ekzistojnë persona që zemërohen pse femrat guxojnë të jenë të zëshme.”

Deklaratë e Kristijana Amanpur (spikere kryesore ndërkombëtare e CNN – udhëheqëse e “Amanpur në CNN dhe PBS”) me rastin e Ditës ndërkombëtare për luftë kundër dhunës ndaj femrave.

“Është e papranueshme që gazetaret të sulmohen apo të keqpërdoren gjatë kryerjes së punës së tyre. Është koha që të fillojmë ta dëgjojmë zërin e vetë femrave.”

Deklaratë e Ajrin Kan, Raportuesja Speciale e OKB-së për avancimin e mbrojtjes së të drejtës për liri të mendimit dhe shprehjes me rastin e Ditës ndërkombëtare për luftë kundër dhunës ndaj femrave.

32 OHCHR Women journalists face violence and sexualized attacks - UN expert #JournalistsToo – Women Journalists Speak Out. Hbyjopk 2021. Qasur më 11.2021 <https://bit.ly/3Gfcnkt>



SIGURIA NË INTERNET E GAZETAREVE NËPËRMJET RAPORTEVE TË ORGANIZATËS PËR SIGURI DHE BASHKËPUNIM NË EVROPË

Më 2 nëntor të vitit 2020, me rastin e Ditës ndërkombëtare kundër mosndëshkueshmërisë së sulmeve ndaj gazetarëve, Zyra e Përfaqësueses së OSBE-së për Liri të Mediave publikoi të ashtuquajturin “Udhëzuesburimesh”³³ për sigurinë në internet të gazetarëve. Ky doracak propozon një sërë aktivitete për dhjetë palë të interesuara për trajtimin e abuzimit me bazë gjinore ndaj gazetarëve. Palët e interesuara përfshijnë edhe pjesëmarrës qeveritar edhe joqeveritar edhe atë: pushteti ekzekutiv, pushteti ligjvënës, gjyqësori, organet e përndjekjes, organizatat ndërqeveritare, ndërmjetësit e internetit, mediat, shoqatat e gazetarëve dhe trupat vetërregullatore, organizatat civile dhe institucionet arsimore, si dhe gazetarët dhe punonjësit mediatik. Doracaku ofron udhëzime konkrete dhe listë të resurseve të dobishme, si dhe shembuj të masave ekzistuese dhe praktikave të mira.

Përveç kësaj, në raportet e Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) theksohet se pothuajse dy nga tre gazetarë kanë përjetuar kërcënime apo kanë qenë të shqetësuar në internet. Vetëm për shkak të gjinisë së tyre, gazetarët janë ballafaquar me nivel shtesë të rrezikut, përkundër të gjitha sulmeve tjera me të cilat gazetarët gjithnjë e më shumë

33 OSCE. *Launch of the #SOFJO Resource Guide*. 2020. Qasur më 04.12.2021 <https://www.osce.org/representative-on-freedom-of-media/467613>.

po ballafaqohen. Në asnjë vend tjetër kjo formë e abuzimit dhe ngacmimit nuk është aq e përhapur sesa në hapësirën në internet.

Pengimi i lirisë së shprehjes paraqet rrezik shtesë si produkt i sulmeve në internet ndaj gazetarëve. Kushdo që kërcënon aftësinë e gazetarëve për ta kryer punën e tyre, shkel të drejtën e tyre për liri të shprehjes aq sa pengon qasjen e lirë dhe të hapur deri tek informacionet për të gjithë shoqërinë.

Udhëzuesi i OSBE-së propozon hapa³⁴ të cilat aktorët kryesorë duhet t'i zbatojnë me qëllim të përmirësimit të sigurisë në internet të gazetarëve. Hapat që i propozon OSBE theksohen në mënyrë taksative dhe kanë të bëjnë me veprimin dhe masat që duhet të ndërmerren nga pushteti ekzekutiv, ligjvënës dhe gjyqësor si dhe organet e përndjekjes siç janë MPB dhe PPTH. Një hap i rëndësishëm që duhet të ndërmarrin qeveritë është krijimi i një plan veprimi kombëtar për sigurinë e gazetarëve, me theks të veçantë tek gazetaret, në mënyrë që të ndikojnë në ngritjen e vetëdijes për të nxitur reagimin e faktorëve kryesorë vendimmarrës dhe publikut.

Pushteti ligjvënës duhet të ndryshojë dhe miratojë ligje me qëllim miratimin dhe zbatimin e qasjes gjinore ndaj sigurisë së gazetarëve, si dhe të sigurojë që ligjet që kanë të bëjnë me shqetësimin në internet të gazetarëve, të mos e varrosin të drejtën e lirisë së shprehjes.

Organet gjyqësore duhet të rrisin ndërgjegjësimin në tërë sistemin gjyqësor për mbrojtjen e gazetarëve, duke rritur profesionalizimin të punësuarve për çështje që lidhen me lirinë e shprehjes, sigurinë e gazetarëve, si dhe shqetësimin dhe keqpërdorimin si në internet ashtu jashtë tij.

Më tej, rekomandimet iu referohen edhe organizatave ndërqeveritare të cilat duhet të mbështesin shtetet për të adresuar zbrastëirat që ekzistojnë në zbatimin e standardeve ndërkombëtare për sigurinë e gazetarëve. Rol të rëndësishëm në sistemin për mbrojtje nga sulmet në internet kanë edhe provajderët e internetit (ISP) të cilët në përputhje me rekomandimet duhet të respektojnë standardet ndërkombëtare për respektimin e të drejtave të njeriut për liri të shprehjes dhe privatësisë, të sigurojnë transparencë në informim për përdoruesit për atë çka paraqet shqetësim në internet dhe keqpërdorim, dhe të bal-

34 OSCE. *What Key Actors Can Do For The Safety Of Female Journalists Online*. Vienna: OSCE 2020. Qasur më 11.12.2021 <https://www.osce.org/files/f/documents/5/e/468894.pdf>

lafaqohen me kërkesat e përdoruesve për mënjanimin e përmbajtjeve, dhe me kërkesat për të fituar të dhëna në mënyrë transparente dhe të vazhdueshme.

Mediat – tradicionale dhe në internet, duhet që ta përmirësojnë kulturën në hapësirat e punës lidhur me çështjet gjinore, të sigurojnë mbështetje për kolegët që ballafaqohen me shqetësim në internet, dhe t'i dokumentojnë e monitorojnë rastet me keqpërdorimet dhe shqetësimet në internet ndaj gazetarëve. Shoqatat e gazetarëve dhe trupat vetë-rregullatore duhet të rrisin veprimet e përbashkëta dhe përfaqësimin me qëllim që të përmirësojnë sigurinë dhe kushtet e punës së gazetarëve, si dhe të organizojnë trajnime, të dokumentojnë sulmet dhe të ngritin vetëdijen tek aktorët kryesor.

Organizatrat civile dhe institucionet arsimore duhet të ndikojnë për rritjen e njohurive dhe vetëdijes për shqetësimin në internet të bazuar në gjini dhe keqpërdorimin ndërmjet disa aktorëve dhe shoqërisë në një kuptim më të gjerë. Në mënyrë plotësuese, rekomandohet që organizatat civile t'i bashkojnë forcat në drejtim të përmirësimit të standardeve të sigurisë dhe kushteve të punës, si dhe integritimit të sigurisë së gazetarëve dhe barazisë gjinore në arsimin e gazetarisë. Vetë gazetarët dhe punonjësit mediatik, mes tjerash, duhet që të dokumentojnë dhe raportojnë për kërcënimet dhe sulmet dhe t'iu ofrojnë mbështetje kolegëve të cilët ballafaqohen me keqpërdorim dhe shqetësim në internet, dhe atyre që janë më të ekspozuar në rrezik ngakëto sulme, si dhe të informohen për format e disponueshme të mbështetjes, përfshi mekanizmat juridike.

13

SIGURIA NË INTERNET E GAZETAREVE NËPËRMJET RAPORTEVE TË KËSHILLIT TË EVROPËS

Çdo vit, organizatat partnere të Platformës për promovim të mbrojtjes së gazetarisë dhe sigurisë së gazetarëve (shkurt “Platforma”) e formuar nga Këshilli i Evropës, publikojnë raport³⁵ në të cilin ofrojnë vlerësim mbi kërcënimet ndaj lirisë së mediave në të gjitha vendet anëtare. Raportet përpilohen në atë mënyrë që organizatat partnere që kontribuojnë për Platformën, mbledhin, kategorizojnë dhe dorëzojnë informacione për kërcënime serioze ndaj lirisë së mediave dhe sigurisë së gazetarëve në nivel të shteteve anëtare.

Informacionet që vijnë deri tek Platforma mundësojnë që Këshilli i Evropës të alarmohet menjëherë dhe në mënyrë sistematike në mënyrë që të mund të ndërmerret veprime të koordinuara dhe në kohë aty ku është e nevojshme. Qëllimi është të përmirësohet mbrojtja e gazetarëve, të ketë reagim më të mirë ndaj kërcënimeve dhe dhunës ndaj gazetarëve dhe punonjësve mediatik, si dhe të përforcohet reagimi i duhur brenda në Këshillin e Evropës.

Në pajtueshmëri me raportin vjetor të publikuar në vitin 2021, i cili u referohet sulmeve ndaj gazetarëve gjatë vitit 2020, për Maqedoninë e Veriut theksohet se:

35 CE. Reports. Qasur më 04.12.2021 - <https://fom.coe.int/rappports>.

“Gazetaret janë cak i ofendimeve dhe kërcënimeve të natyrës seksuale në bazë gjinore. Tanja Milevska, korrespondente nga Brukseli e Agjencisë për Informim të Mediave (MIA) u ballafaqua me ngacmim në internet, duke përfshirë edhe ngacmim verbal me kërcënime për jetë dhe kërcënim për përdhunim nëpërmjet rrjeteve sociale. Kjo ndodhi pasi që ajo nëpërmjet Twitter-it pyeti nëse kryeministri i Hungarisë Viktor Orban dhe Partia Popullore Evropiane në Parlamentin Evropian do të njohin amendamentet e Kushtetutës që ndryshuan emrin e shtetit në Maqedonia e Veriut. Në Maqedoninë e Veriut, Meri Jordanovska, redaktore e portalit A1on.mk dhe Iskra Koroveshovska, redaktore e TV Alfa, kanë marrë kërcënime dhe ofendime me bazë gjinore.”³⁶

Siç theksohet në këtë raport, madje 64 për qind nga numri total i sulmeve ndaj gazetarëve në vitin 2020 janë sulme ndaj gazetarëve femra, ndërsa shumica e këtyre sulmeve janë bërë duke shfrytëzuar platforma të ndryshme të internetit dhe rrjeteve sociale.

Në mënyrë shtesë sa i përket shqetësimit në internet ndaj gazetarëve theksohet se:

“Gjatë vitit 2020, është vërejtur një vërshim i ngacmimit në internet të gazetarëve, të cilat në disa raste ishin nxitur nga politikanët. Në mënyrë të veçantë cak ishin gazetaret të cilat u ballafaquan me ofendime të bazuara në gjini dhe kërcënime të natyrës seksuale. Platformat e internetit dhe autoritetet ishin të ngadalshëm në gjetjen e përgjegjësive për sulmet në internet, madje edhe kur ishin dorëzuar parashitresat formale”³⁷

Një nga rekomandimet e bëra nga organizatat partnere për media që përpilojnë këtë raport, është që shtetet anëtare të sjellin ligje dhe mekanizma për mbrojtje institucionale me synim ndjekjen dhe pengimin e abuzimit të gazetarëve në internet, si dhe të kushtojnë vëmendje të veçantë dhe të ndërmarrin masa kundër keqtrajtimit të synuar ndaj gazetarëve dhe punonjëset mediatike.

Keqtrajtimi në internet, e sidomos kërcënimet ndaj gazetarëve theksohen si

36 CE. Platforma. *Annual Report by the partner organisations to the Council of Europe Platform to Promote the Protection of Journalism and Safety of Journalists 2021*. Strazburg: CE. Platforma 2021, 54. Qasur më 04.12.2021 - <https://rm.coe.int/final-version-annual-report-2021-en-wanted-real-action-for-media-freed/1680a2440e>

37 CE. Platforma. *Annual Report by the partner organisations to the Council of Europe Platform to Promote the Protection of Journalism and Safety of Journalists 2021*. Strazburg: CE. Platforma 2021, 11-12. Qasur më 04.12.2021 - <https://rm.coe.int/final-version-annual-report-2021-en-wanted-real-action-for-media-freed/1680a2440e>

problem serioz edhe në raportin e vitit 2020³⁸ i cili u referohet rasteve të denoncuar në vitin 2019, në të cilin thuhet:

“Gazetarët dhe punonjësit mediatik janë vënë në shënjestër të kërcënimeve me dhunë në internet, ngacmimeve dhe gjuhës së urrejtjes me pothuajse pandëshkueshmëri të plotë, shpesh në mënyrë anonime nga të ashtuquajturit trolle dhe përdorues në rrjetet sociale, por në disa raste haptazi edhe nga persona publik me qëllime hakmarrëse. Gazetaret janë veçanërisht të ndjeshme dhe shpesh janë cak i sulmeve personale apo sulmeve me përmbajtje eksplicite seksuale.”³⁹

Në Raportin e vitit 2019⁴⁰ theksohet se ka pasur sulme brutale në nivel global ndaj gazetarëve nëpërmjet fushatave të organizuara në internet me qëllim njollosjen e tyre.

38 CE. Patforma. *Annual Report by the partner organisations to the Council of Europe Platform to Promote the Protection of Journalism and Safety of Journalists 2020*. Strazburg: CE. Patforma 2020. Qasur më 04.12.2021 - <https://rm.coe.int/annual-report-final-en/16809f03a9>

39 Ibid. 10.

40 CE. Patforma. *Annual Report by the partner organisations to the Council of Europe Platform to Promote the Protection of Journalism and Safety of Journalists 2019*. Strazburg: CE. Patforma 2019, Qasur më 04.12.2021 - <https://rm.coe.int/annual-report-2018-democracy-in-danger-threats-and-attacks-media-freed/1680926453>

14

RISHQYRTIM I SULMEVE NË INTERNET NDAJ GAZETAREVE NË RMV NËPËRMJET PRAKTIKËS INSTITUCIONALE

S iç shihet nga statistikat e analizuarra në këtë raport, trendi i sulmeve ndaj gazetarëve merr dimension gjinor, respektivisht, më shumë se gjysma e sulmeve të përgjithshme ndaj gazetarëve në vitin 2020 dhe 2021, janë ndaj gazetarëve femra nëpërmjet platformave të internetit apo rrjetëve sociale. Sulmet në internet ndaj gazetarëve gjatë ushtrimit të punës së tyre në mënyrë plotësuese përforcohen me diskriminim mizogjen dhe seksist. Faktorët që kontribuuan për këtë gjendje janë të shumtë, dhe një prej tyre është sigurisht pandemia e cila “në nivel lokal solli deri tek ndasitë ndërmjet qytetarëve, ku narrativat publike kryesisht në mediat sociale por edhe në ato tradicionale, në përgjithësi i arsyetonin apo nuk i arsyetonin masat kufizuese kundër Covid-19”.⁴¹ Në mënyrë shtesë, zgjedhjet e parakohshme parlamentare në korrik të vitit 2020, temat e lidhura me bllokimin e Bullgarisë ndaj Maqedonisë së Veriut për fillimin e negociatave me Bashkimin Evropian, regjistrimi i planifikuar i popullsisë, e gjithë kjo kontribuoi për nxehjen e debatit politik në rrjetet sociale, ku si dëm kolateral u gjetën gazetarët, sidomos gazetarët që u ballafaquan me sulme të bazuara në gjini.

Duhet theksuar se numri real i sulmeve ndaj gazetarëve supozohet të jetë

41 Sabrioski, S. Atovska, K. “14 sulme ndaj gazetarëve, 14 sulme ndaj demokracisë” Shkup. SHGM 2021, 4.

shumë më i lartë nga ajo që tregon statistika, sidomos ato që janë kryer në internet, sepse supozohet se jo të gjithë ato vendosin t'i denoncojnë rastet në organet kompetente si MPB apo PPTH, apo deri tek organizatat dhe sindikatat gazetareske. Mosndëshkimi, efikasiteti i dobët i organeve të ndjekjes, hetimet joefikase, frika nga pasojat dhe hakmarrja, të gjitha këto ndikojnë që viktimat e këtij lloji të sulmeve të mos i denoncojnë dhe thjeshtë të tërhiqen nga puna apo tërësisht të vetë-cenzurohen. Kjo sidomos ndikon në punën profesionale të gazetaresve me pasoja për tërë shoqërinë sepse kështu shkatërrohet gazetaria hulumtuese e cila në një farë mënyrë është korigjues i pushtetit në luftën kundër korrupsionit dhe ngrit nivelin e vetëdijes publike për çështje të caktuara me interes publik.

Problemi me mosndëshkueshmërinë në shumicën e rasteve të sulmeve ndaj gazetaresve në sferën e internetit, mund të gjendet edhe tek zgjidhjet ligjore dhe zbatimi i tyre nga ana e prokurorisë.

Një nga dispozitat e Kodit Penal të RMV-së sipas të cilit ekzistojnë vendime të prokurorisë për temën e përpunuar në këtë raport është neni 144 – “Kërcënim i sigurisë”:

Neni 144

(1) Ai që kërcënon sigurinë e tjetrit me kërcënim serioz për sulm ndaj jetës ose trupit të tij, apo jetës ose trupit të ndonjë personi të afërt të tij, do të dënohet me dënim me para apo me burg deri në gjashtë muaj.

(2) Ai i cili do të kryejë veprën nga paragrafi 1, gjatë dhunës familjare apo nga urrejtja, do të dënohet me burg nga tre muaj deri në tre vite.

(3) Me dënimin nga paragrafi 2 do të dënohet ai i cili veprën nga paragrafi 1 do ta bëjë ndaj personit zyrtar gjatë ushtrimit të detyrës apo ndaj më shumë personave.

(4) Ai i cili nëpërmjet sistemit informatik kërcënohet se do të kryejë veprë penale për të cilën është paraparë dënim me burg prej pesë vitesh apo dënim më të rëndë kundër ndonjë personi për shkak të përkatësisë së ndonjë gjinie të caktuar, racës, ngjyrës së lëkurës, përkatësisë gjinore, shtetësisë, përkatësisë në ndonjë grup të marginalizuar, përkatësisë etnike, të gjuhës, shtetësisë, prejardhjes sociale, religjionit apo besimit, formave tjera të bin-

djeve, arsimit, përkatësisë politike, statusit personal apo shoqëror, pengesës mentale apo trupore, moshës, gjendjes familjare apo martesore, gjendjes pronësore, gjendjes shëndetësore apo në çfarëdo baze tjetër të paraparë me ligj apo me marrëveshje të ratifikuar ndërkombëtare, do të dënohet me burg prej një deri në pesë vite.

(5) Përndjekja për veprën penale nga paragrafi (1) ndërmerret nëpërmjet pa-disë private.“

Praktika lidhur me përdorimin e këtij neni, në kontekst të mbrojtjes së sigurisë së gazetarëve në internet, është më shumë negative se sa pozitive. Respektivisht, *“formë e kualifikuar në nenin 2 të veprës është nëse vepra kryhet nga urrejtja. Formë tjetër edhe më e rëndë e kësaj vepre penale është nga paragrafi 4 i nenit ku kërcënimi realizohet nëpërmjet sistemit informatik. Për ekzistimin e kësaj forme të veprës penale, duhet që të plotësohen të gjitha kushtet në mënyrë kumulative dhe të vërtetohet kauzaliteti.”*⁴²

Pikërisht shkak i kushteve të parapara në nenin 4 , buron edhe praktika negative, gjegjësisht refuzimi i kallëzimeve penale për sulme ndaj gazetarëve nëpërmjet sistemit informatik, për shkak të nevojës për plotësimin kumulativ të të gjitha kushteve dhe vërtetimit të shkakut për ekzistimin e formës së tillë më të rëndë të veprës penale, si dhe nga interpretimi subjektiv i kërcënimeve të shprehura nga ana e sulmuesve.

Një shembull i vendimit të prokurorit publik që duhet theksuar është ai që u ndërmor pas denoncimit për sulm ndaj gazetares Sllobodanka Jovanovska – Zhizhi, në formë të vendimit të regjistruar me nr. KO1 nr.546/16 nga 18.9.2017⁴³ nga PPTH Shkup, ku prokuroria kompetente refuzoi kallëzimin kundër personit me iniciale M.N për veprën penale “kërcënim të sigurisë” sipas nenit 144, paragrafi 4, “dhunë” sipas nenit 386, paragrafi 1, dhe “Shpërndarje e materialeve raciste dhe ksenofobike nëpërmjet sistemit kompjuterik”, sipas nenit 394-g, paragrafi 1 nga Kodi Penal i RMV-së, pasi për veprat e denoncuar nuk parashihet përndjekje sipas detyrës zyrtare”. Në mënyrë shtesë, pas ankesës nga gazetarja e dëmtuar, Prokuroria e Lartë me vendimin IV KOЖ/1 nr.486/17 nga 27.11.2017 e refuzon kërkesën dhe e vërteton vendimin e shkallës së parë.⁴⁴

42 Aleksandar Markoski. “Rishikim i gjuhës së urrejtjes nëpërmjet prizmit prokuroria, provë në procedurë dhe leksionet e mësuara” Shkup, AGJPP “Pavell Shatev” 2021, 3.

43 PPTH Shkup, Vendimi KO1 nr.546/16. Shkup 18.9.2017.

44 PPL Shkup, Vendimi IV KOЖ/1 nr.486/17. Shkup 27.11.2017.

Në këtë rast bëhet fjalë për status në Facebook të personit M.N të postuar më 9 korrik 2016, lëndë e cila morri epilog përfundimtar me vendim të Prokurorisë së Lartë nga data 27.11.2017, ndërsa ka përmbajtjen si vijon:

*“Ambasada njëherë po digjej. Ambasadori në strehën atomike u dh** në brekë. Bashkë me disa të vetëquajtura gazetares. Atëherë e shpëtuan b****n. Kësaj radhe së bashku me Zhizhin do të kaloni në vendgjuetitë e përjetshme. Si një shembull për të gjithë ata që duan ta rrënojnë shtetin. Secili armik që do të hyjë aty, nuk do të dalë më i gjallë.”*

Në vendimin e cituar më lartë nga PPTH në pjesën ku refuzohet kallëzimi penal sipas nenit 144, paragrafi 4, prokurori kompetent thotë:

“Materiali i shkruar nuk përmban ndonjë kërcënim të shprehur për kryerjen e ndonjë veprë penale nga i denoncuari, aq më tepër që e njëjta nuk përbën kërcënim për kryerjen e veprës penale për të cilën parashihet dënim me burg deri në pesë vite apo dënim më i rëndë, që është element përbërës për plotësimin e veprimit të veprës së denoncuar penale, dhe për këtë arsye konstatoj se elementet ligjore të veprës penale “Kërcënim i sigurisë” sipas nenit 144 , paragrafi 4 nga Kodi Penal nuk janë të plotësuara.”

Këtë vendim mund ta “shënojmë” si shembull negativ sa i përket mbrojtjes së sigurisë së gazetareve në internet, shkaku se në mënyrë që prokuroria kompetente të marrë përsipër përndjekjen sipas detyrës zyrtare dhe ta vazhdojë procedurën, duhet që në mënyrë kumulative të plotësohen kushtet nga paragrafi 4 i nenit 144, respektivisht është me rëndësi të ketë kërcënim eksplicit për kryerjen e veprës penale për të cilën është parashikuar dënim me burg prej pesë vitesh apo dënim më të lartë.

Në këtë rast është simptomatike që Prokuroria nuk i merr parasysh fjalët nga statusi i Facebook-ut nga i denoncuari: *“Kësaj radhe, së bashku me Zhizhin do të kaloni në vendgjuetitë e përjetshme”* – kur dihet se në gjuhën popullore thënia *“do të kaloni në vendgjuetitë e përjetshme”* mund të aludojë në likuidimin e gazetares së përmendur, megjithatë prokuroria në këtë rast nuk vlerëson se këto fjalë janë kërcënim për kryerjen e veprës penale për të cilën parashihet dënim me burg prej pesë apo më shumë vitesh. Në mënyrë shtesë, kërcënimi i sigurisë së viktimës në këtë rast përforcohet nga pohimet se ajo ka dashur ta rrënojë shte-

tin” dhe “secili armik që do të hyjë aty, nuk do të dalë më i gjallë”, dhe fjalë të tilla lehtë mund të provokojnë persona apo grupe të kryejnë veprë penale ndaj viktimës duke u provokuar nga statusi i Facebook-ut të personit të denoncuar pasi që ai e identifikon viktimën me pseudonimin e saj, nëpërmjet të cilit njihet në opinion.

Nga kjo rrjedh se kushdo me kërcënim të shprehur në mënyrë metaforike mund të mbetet i pandëshkuar, gjë që forcon edhe më tej “efektin ftohës” tek viktimat – gazetarë që të tërhiqet nga puna e saj, apo të shkaktojë pasoja më të rënda në shëndetin e saj psiko-fizik.

Pas vendimit të Prokurorisë së Lartë IV KOJ/1 nr.486/17 nga 27.11.2017, që vendosi për ankesën e deklaruar nga ana e gazetares Slobodanka Jovanovska në pjesën ku jepet arsyetimi për nenin 144, paragrafi 4 mes tjerash thuhet:

“Konstatimi i prokurorit publik për veprën penale – “Kërcënim i sigurisë” nga neni 144, paragrafi 4 nga Kodi Penal është i drejtë, sepse materiali i shkruar nga ana e të denoncuarit nuk përmban kërcënim të shprehur për veprim të çfarëdo veprë penale pasi nuk buron kërcënim për kryerjen e veprës penale për të cilën parashihet dënim me burg deri në pesë vite apo dënim më i rëndë, e që është element përbërës për plotësimin e kryerjes së veprës së denoncuar penale.”

Shembull pozitiv për veprimin e Prokurorisë Publike kur bëhet fjalë për kërcënim në internet ndaj gazetarit është kërcënimi nëpërmjet Facebook-ut nga personi me iniciale T.M kundër gazetarit Branko Triçkovski. I akuzuari ka shkruar se “do të mund të vriste gazetarin Triçkovski pa iu trembur syri”. Kërcënimi është denoncuar në MPB. Për këtë rast, SHGM dorëzoi kërkesë deri tek PPTH që të veprojë, pas çka ishte hapur procedurë para gjykatës kompetente dhe procesi mbaroi me vendim të plotfuqishëm gjyqësor në favor të gazetarit.⁴⁵

Për këtë ngjarje, vërehet qartë se në fjalët e shkruara nga i pandehuri, prokuroria dhe gjykata për rrjedhojë kanë konstatuar se në mënyrë kumulative janë plotësuar të gjitha kushtet për ekzistimin e kryerjes së veprës penale nga paragrafi 4 i nenit 144 të KP, përkatësisht kërcënimi për veprë penale për të cilën parashihet dënim me burg prej pesë vitesh ose më lart, si dhe lidhja shkak-pasojë ndërmjet kërcënimit dhe përkatësisë së të dëmtuarit në grup të caktuar.

45 Ivanov, Z. Markovski, I. “Kronikë për (pa)sigurinë e gazetarëve” Shkup: SHGM 2019, 12.

Një shembull tjetër pozitiv nga praktika vendore, në drejtim të mbrojtjes së sigurisë së gazetareve, është rasti me gazetaren Meri Jordanovska – Çançareviq. *“Vendimi për rastin me gazetaren Meri Jordanovska kundër Emil Jakimovskit ishte shqiptuar në Gjykatën Penale në Shkup nga ana e gjykatëses Xheneta Bektoviq. Prokuroria dha propozimin ndërsa gjykata e pranoi. Emil Jakimovski u dënua me një vit dhe tetë muaj burg për kërcënim të sigurisë së ish bashkëshortes së tij dhe për kërcënimet e adresuara ndaj gazetares Meri Jordanovska.”*⁴⁶

Me vendim të plotfuqishëm K.nr.212/20 nga 16.3.2020⁴⁷ pas ngritjes së akuzës nga ana e PPTH Shkup, gjykata shpalli të akuzuarin Emil Jakimovski fajtor dhe i shqiptoi dënim të vetëm me burg në kohëzgjatje prej (1) – një viti, dhe tetë (8) muaj, ndërsa me vendim plotësues, Gjykata të akuzuarit i shqiptoi edhe masë të sigurisë – mjekim dhe qëndrim të detyruar psikiatrik në institucion shëndetësor, edhe atë për veprën penale të kryer sipas nenit 144, paragrafi 4. Në pikën e dytë të aktgjykimit të cekur që i referohet të dëmtuarës Meri Jordanovska – Çançareviq, Gjykata theksoi:

Kërcënimet e drejtuara ndaj gazetares në këtë rast janë dërguar nëpërmjet aplikacionit “Telegram” në formë të mesazheve tekstuale dhe me përmbajtjen në vazhdim: “A ke dëgjuar për koktej molotovi”, “do të q.* dhe do të bllokohehsh”, “ja se çfarë të pret ty dhe Zokin”, e shoqëruar me fotografi me pranga, duke aluduar në kryetarin e LSDM-së Zoran Zaev, “do të të publikojnë nekrologji”.

Gjykata theksoi se i pandehuri: *“në ditën kritike, në gjendje të llogaritjesdukshëm të dobësuar që të kuptojë mirë dhe të menaxhojë veprimet e veta, të shkaktuar nga çrregullimi kronik mendor - çrregullim afektiv bipolar, përmes sistemit informativ, aplikacionit “Telegram” ka kanosur të dëmtuarën Meri Jordanovska - Çançareviq se do të kryejë vepër penale – “Vrasje” nga neni 123 paragrafi 1 i Kodit Penal, për çka parashihet burg prej së paku (5) - pesë vjet, për shkak të gjinisë së saj, përkatësisë politike, statusit personal dhe shoqëror, siç është përshkruar në mënyrë të plotë në gjendjen faktike”.*

Është interesante të theksohet se në këtë rast, Prokuroria e më pas edhe Gjykata në fjalët kërcënuese që i pandehuri ia ka dërguar të dëmtuarës Meri Jordanovska Çançareviq nëpërmjet “Telegram”-it, kanë gjetur elemente të kërcënimit për të kryer veprën penale – Vrasje, respektivisht në përputhje me paragrafin 4

46 Sabrioski, K. Atovska, K. “14 sulme ndaj gazetareve, 14 sulme ndaj demokracisë” Shkup : SHGM 2021, 21.

47 Sud.mk. Aktgjykimi K.nr.212/20 nga 16.3.2020. www.sud.mk Qasur më 10.12.2021

nga neni 144 i Kodit Penale për kryerje të veprës penale, kërcënim për kryerje të veprës penale për të cilën është paraparë dënim me burg prej pesë ose më shumë vitesh, ndërsa në fjalët e rastit të lartpërmendur me gazetaren Sllobodanka Jovanovska – Zhizhi, nuk arriti të gjejë element të tillë.

Diskrepanca është e qartë, respektivisht Prokuroria gjen mjaftueshëm elemente për të ngritur aktakuzë nga fjalët “do të të publikojnë nekrologji”, ndërsa në rastin e parë “atëherë shpëtuat b***”, “kësaj here së bashku me Zhizhin do të shkoni në vendgjuetitë e përjetshme”, nuk gjen elemente për kërcënim për veprën penale vrasje, gjegjësisht nuk vlerëson se është plotësuar veprimi për formë më të rëndë të veprës penale nga neni 144, paragrafi 4 nga Kodi Penal.

Ky veprim subjektiv i prokurorisë dhe praktika jo e harmonizuar sjell deri tek mosbesimi ndaj institucioneve dhe gjithsesi ndikon negativisht ndaj avancimit të sigurisë së gazetareve në sferën në internet.

Në kontekst të asaj që është shkruar, në një shpjegim të Prokurorisë Themelore nga Shkupi thuhet:

“Sipas Ligjit për Procedurë Penale, prokurori publik është i autorizuar që të përndjekë autorë të veprave penale të cilat përndiqen sipas detyrës zyrtare, e jo sipas pade private. Për shembull, për veprën penale – “Kërcënim të sigurisë” nga neni 144, nga KP, sipas të cilit ai i cili do ta kërcënojë sigurinë e tjetrit me kërcënim serioz për sulm ndaj jetës apo trupit të tij, apo jetës dhe trupit të ndonjë të afërmi të tij, do të dënohet me dënim me para apo me burg deri në gjashtë muaj, në pajtueshmëri me paragrafin 5 nga i njëjti nen, përndjekja për këtë vepër do të ndërmerret me padi private. Sipas nenit 122 nga Kodi Penal, gazetarët janë persona që kryejnë punë me interes publik dhe nuk kanë cilësinë e personave zyrtarë, kështu që kur me veprën penale janë të mbrojtur vetëm personat zyrtarë, nuk mund të kërkohet mbrojtje edhe për personat që kryejnë punë me interes publik, nëse kjo në mënyrë taksative nuk është e theksuar në normën juridike, siç është theksuar për shembull në paragrafin 3 të nenit 144 nga KP, ku mbrohet vetëm personi zyrtar gjatë kërcënimit të sigurisë, e jo edhe personat të cilët kryejnë punë me interes publik.”⁴⁸

Ky qëndrim i Prokurorisë korrespondon me qëndrimet e SHGM-së dhe të Sindikatës së Pavarur të Gazetarëve dhe Punonjësve Mediatik (SPGPM) ku nëpërmjet

48 Prokuroria Themelore Publike, “Lënda : Informatë A nr.474/21 nga 27.9.2021”.

ndryshimeve në Kodin Penal, gazetarët do të merrnin trajtimin e njëjtë sikurse personat zyrtarë me çka do të parashiheshin forma më të rënda veprave penale, me qëllim që të ndikohet në mënyrë preventive ndaj autorëve potencial.⁴⁹ Megjithatë këtu duhet pasur kujdes për shkak se diapazoni më i gjerë i veprave penale të kryera nga persona zyrtarë parasheh dënime më të rrepta nga forma themelore e veprës penale, ndërsa *“argument shtesë përse gazetarët nuk mund të njëjtësohen me personat zyrtarë në pjesën e dënimeve më të larta është edhe fakti se gazetarët nuk disponojnë me mjete publike.”*⁵⁰

Në Maqedoninë e Veriut regjistrohen edhe sulme tjera në internet ndaj gazetaeve, si për shembull **sulmi në rrjetet sociale ndaj gazetares Natasha Stojanovska nga TV Telma më 13.01.2020, dhe sulmi ndaj gazetares Aneta Dodevska nga TV 24** e cila më 18.01.2020 morri porosi me përmbajtje: “Ti je një turp për popullin maqedonas, andaj duhet ta ndërrosh fenë, por ti nuk je fajtores, duhej të të vrisja derisa ishit tek Gazella”. Profili i Facebook-ut nëpërmjet të cilit është dërguar kërcënimi ishte i regjistruar me pseudonimin “Ivo Bucim”. Dodevska thekson se sulmet e tilla ndodhin shpesh pas intervistave të saj me ndonjë funksionar dhe të njëjtat nuk janë ndalur edhe pasi që SHGM e ka denoncuar rastin në MPB. Më tej, gazetarët ballafaqohen me sulme edhe nëpërmjet linjave telefonike, si për shembull **ndaj gazetares Almedina Ismaili e TV21** e cila ka marrë kërcënime nga anëtar i një partie politike me fjalët “Besoj se nuk ju kanë rrahur qëmoti. Do të të vras nëse e publikon lajmin”. **Gazetarja Miroslava Bërns ka marrë një sërë kërcënimesh** në vrullin e pandemisë me Kovid-19 në profilin e saj personal në Facebook për shkak të publikimit të tekstit për një dasëm të mbajtur në Tetovë duke kujtuar se kjo është në kundërshtim të rregullativës ligjore që ka të bëjë me luftën kundër pandemisë së Kovid-19.⁵¹ **Shembull tipik** të sulmit ndaj gazetaeve me dozë të madhe të gjuhës seksiste, mizogjene, të dhunës, degraduese dhe ofenduese, janë sulmet ndaj gazetaeve Iskra Koroveshovska dhe Meri Jordanovska nëpërmjet sms porosive, aplikacioneve, dhe ngjashëm.

Rasti me sulmet në Twitter ndaj gazetares Tanja Milevska gjatë kohës së fushatës zgjedhore të zgjedhjeve parlamentare në korrik të vitit 2020, dhe pyetja që ia parashtrou në konferencë për media kryeministrit hungarez Viktor Orban, është një shembull tipik për hajkë të organizuar ndaj gazetares nëpërmjet të ashtu-

49 SHGM. SPGPM. SHGM dhe SPGPM: “Sulmet ndaj gazetarëve të trajtohen si sulme ndaj personave zyrtarë” Shkup 2019. Qasur më 11.12.2021 <https://bit.ly/3lYxa41>

50 Bogdanov, K. Breshkovski, I. Sekullovska, D. Përmirësimi i sigurisë së gazetarëve nëpërmjet ndryshimit të Kodit Penal. Shkup: KAS, SHGM 2020, 39.

51 360Stepeni.mk. Dënim i ashpër për kërcënimet ndaj gazetares Miroslava Bërns. Shkup 2020. Qasur më 11.12.2021 <https://360stepeni.mk/ostra-osuda-za-zakanite-kon-novinar-kata-miroslava-burns/>

quajturave bote në Twitter me gjuhë të urrejtjes të bazuar në gjini për shkak të qëndrimeve të saj ndaj temave të caktuara politike. Për fat të keq, kjo lëndë nuk është paraqitur në MPB dhe Prokuroria nuk ka hapur procedurë në bazë të informacioneve të saj.⁵² Është gjithashtu e rëndësishme të përmendet fakti se lënda e formuar në Prokurori kundër një deputeti të përbërjes aktuale në Parlamentin e RMV-së për shkak të statusit të tij në rrjetet sociale ku e përmend gazetaren, është lëndë në të cilën Prokuroria ende po vepron.

Veprimi i institucioneve në rastet e sulmeve në internet ndaj gazetarëve, sidomos veprimi i MPB-së, dëshmon një nivel të caktuar të standardeve të dyfishta lidhur me shpejtësinë e veprimit sepse vepron shumë më shpejtë kur bëhet fjalë për sulm ndaj funksionarit qeveritar në krahasim me rastet kur janë të sulmuar gazetarët.⁵³ Është e rëndësishme të theksohet se **në të gjitha rastet e lartpërmendura është fakti se shumica prej tyre kanë mbetur pa u denoncuar në institucione, respektivisht në MPB si hallka e parë dhe themelore për mbrojtjen e sigurisë së gazetarëve.**

Në këtë kontekst është edhe qëndrimi i Prokurorisë, e cila thekson:

“Në pajtueshmëri me Ligjin për procedurë penale dhe Ligjin për polici, organi kompetent për të vërtetuar identitetin e autorëve të veprave penale është MPB, për shkak se në bazën e MPB-së gjenden emrat dhe mbiemrat, numrat personal, adresat e jetesës, kështu që prokurori publik mund të përndjekë vetëm autorë të njohur të veprës penale me të dhëna të sakta personale.

Nëse është denoncuar autor i panjohur, prokuroria kërkon nga MPB-së të vërtetojë identitetin e autorit të veprës penale. Në pajtueshmëri me dispozitat e lartpërmendura ligjore, MPB është po ashtu organ i autorizuar që të sigurojë të gjitha provat materiale dhe të njëjtat t’i dorëzojë deri tek prokurori publik, por kur nevojitet urdhër nga prokurori, MPB është organ i autorizuar që të kërkojë urdhërin e prokurorit për të siguruar prova dhe në këtë rast prokurori menjëherë jep urdhër të tillë.”⁵⁴

Raportet e Prokurorisë tregojnë se Prokuroria në vitin 2021 ka formuar lëndë për sulmet e përmendura në internet ndaj gazetarëve edhe pse rastet e tilla

52 SHGM. SPGPM. KEMM. SHGM, SPGPM dhe KEMM i dënojnë ashpër kërcënimet ndaj korrespondentes Milevska. Shkup 2020. Qasur më 11.12.2021 <https://bit.ly/3lVHZDE>

53 MPB. Kallëzim penal për kërcënim të sigurisë dhe shpërndarje të materialit ksenofobik dhe racist nëpërmjet sistemit kompjuterik. Shkup 2018. Qasur më 2.12.2021 <https://mvr.gov.mk/vest/7644>

54 PPTH Shkup. Lënda: Informata A nr.474/21. Shkup 27.9.2021.

nuk janë paraqitur në MPB siç janë rastet me gazetaret Aneta Dodevska dhe Natasha Stojanovska, megjithatë për të dyja rastet e regjistruara me numrin PO nr.965/20, Prokuroria ka sjellë vendim me të cilën “ka konstatuar se nuk ka vend për intervenim të prokurorit”. Për gazetaret Tanja Milevska dhe Almedina Ismaili janë hapur lëndë dhe për to Prokuroria po ndërmer veprime që janë në vijim e sipër.

Problemi me mbledhjen e provave dhe identifikimin e autorëve në rastet e sulmeve në internet ndaj gazetarëve dhe në përgjithësi ndaj gazetarëve, qëndron në faktin se për një numër të madh rastesh duhet bërë kërkesë për ndihmë ndërkombëtare juridike deri tek përfaqësitë zyrtare të rrjeteve sociale. Praktika tregon se këto procedura zgjasin tejet shumë dhe mbarojnë me mossakses, respektivisht organet e përndjekjes nëpërmjet Ministrisë së Drejtësisë shumë rralë arrijnë deri tek të dhënat e nevojshme kompjuterike. Duhet theksuar se edhe vetë kërcënuesit, pavarësisht se a përbëhen prej grupeve apo individëve, janë të zotë në fshehjen e gjurmëve të tyre në sferën në internet, duke përdorur servise nëpërmjet të cilave është shumë e vështirë që të gjendet autori.

“Ekziston mundësi edhe për kërkesë preliminare nga ana e organeve të përndjekjes për ruajtjen e të dhënave nga ana e Facebook-ut. Në situata kur është e nevojshme një kohë e caktuar për të procesuar procedura formalo-juridike nga shteti që parashtron kërkesën për të dhënat, Facebook-u mund t’i ruajë të dhënat e kërkuara kompjuterike. Kërkesa (më shumë si lutje) që të ruhen të dhënat e caktura deri në momentin e arritjes së dokumentacionit formalo-juridik mund të bëhet nëpërmjet sistemit në internet për dorëzim të kërkesës nga ana e Prokurorisë apo policisë, nëpërmjet postës elektronike, faksit apo postës së rregullt. Afati maksimal për ruajtjen e të dhënave është 90 ditë.”⁵⁵

Për nevojat e hetimit që ka për qëllim gjetjen e autorëve të veprave penale në internet, nevojiten procedura të ndërlikuara, dhe në mënyrë shtesë duhet të sigurohen të dhënat për përdoruesin, respektivisht IP adresën apo adresat që përdoren nga ndonjë person i caktuar që janë ndër të dhënat më të kërkuara gjatë zhvillimit të hetimit. Prokuroria publike këto të dhëna i merr duke dërguar kërkesë deri tek provajderët vendorë të internetit ose të njejtën mund ta bëjë nëpërmjet Sektorit për kriminalitet kompjuterik dhe forenzikë digjitale.

55 D-r Aleksandar Markoski. “Rishikim i gjuhës së urrejtjes nëpërmjet prizmit prokurorial. Prova në procedurë dhe leksione të mësuara” Shkup : AGJPP “Pavell Shatev” 2021, 34.

Kur bëhet fjalë për sulmet ndaj gazetarëve, sidomos ndaj gazetarëve ku haset dozë e madhe e gjuhës së urrejtjes bazuar në gjini, që shprehet nëpërmjet rrjeteve sociale apo nëpërmjet platformave tjera për komunikim, vërejmë se këto sulme ndikojnë edhe për nxitjen e krimit nga urrejtja, respektivisht nxisin persona të tretë për të kryer vepra penale ndaj viktimave.

Shteti, nëpërmjet organeve të përndjekjes duhet t'i zbatojë të gjitha rekomandimet nga partnerët relevant të përmendur në këtë raport, në mënyrë që të vendosë një sistem efikas, të përgatitur teknikisht dhe të harmonizuar, që do të mbrojë gazetarët, dhe veçanarisht do të parandalonte sulmet me bazë gjinore ndaj gazetarëve.

Me propozim ndryshimet dhe plotësimet në Kodin Penal të RMV-së⁵⁶ nga korriku i vitit 2021, të cilat Qeveria e RMV-së si propozues i dorëzoi deri tek Kuvendi, do të intervenohet në fusha të catuara nëpërmjet të cilave do të përmirësohej situata me sigurinë e gazetarëve nëpërmjet **“...implementimit të Konventës së Stambollit, intervenimit në veprat penale që kanë të bëjnë me sigurinë e gazetarëve, ndryshimit të dispozitave të caktuara nga Kodi Penal (në sferën e konfiskimit dhe torturës) si rezultat i disa aktgjyqimeve të sjella nga Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut me të cilat vërtetohet shkelje të dispozitave të Konventës, si dhe harmonizimit të Kodit Penal me Direktivën (BE) 2017/1371 për luftë kundër mashtrimit lidhur me interesat financiare të Unionit duke zbatuar të drejtën penale.”⁵⁷**

Është me rëndësi të theksohet se gjatë përpilimit të këtyre propozim ndryshimeve dhe plotësimeve të Kodit Penal kanë marrë pjesë dhe janë konsultuar edhe shoqatat gazetareske në vend, me qëllim avancimin e sigurisë së gazetarëve në internet dhe jetën reale.

Në mënyrë shtesë, zgjidhjet e vendosura në këto propozim ndryshime dhe plotësime janë bazuar në “Konventën e Këshillit të Evropës për parandalim dhe luftim kundër dhunës ndaj grave, përfshi edhe dhunën familjare” – Konventën e Stambollit. Kjo nënkupton se në të ardhmen në Kodin Penal do të përdoret fjalor i ndjeshëm ndaj gjinisë në vend të gjuhës neutrale, do të garantohen dimensionet gjinore në definimin e veprave penale, do të ndryshojë ligji me qëllim që të definohet dhuna psikike, do të inkriminohet vepra “përndjekje” si vepër e re penale

56 Qeveria e RMV-së. *Propozim i Ligjit për ndryshim dhe plotësim të Kodit Penal*. Shkup: 2021. Qasur më 18.12.2021 <https://bit.ly/3q9buU4>

57 Ibid. 3.

me të cilën do të parashikohen sanksione për autorët, por në të njëjtën kohë edhe për mbrojtjen e viktimave si dhe do të inkriminohet “ngacmimi seksual” si veprë penale, dhe do të definojnë sanksionet kundër autorëve.

Me propozim ndryshimet dhe plotësimet e Kodit Penal në drejtim të sigurisë së gazetarëve, do të intervenohet në vepra të caktuara penale me formë të klasifikuar në qoftë se vepra është kryer ndaj gazetarit për çka do të parashihen vepra më të rrepta penale. Veprat në Kodin Penal që do të pësojnë intervenim janë: vrasje, pengim i personave zyrtarë gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare, kërcënim i sigurisë, dhe detyrim.

Nëpërmjet intervenimit në nenin 123 –“Vrasje” nga Kodi Penal, respektivisht në paragrafin 2 ku përkufizohet forma e kualifikuar e veprës për të cilën parashihet dënim minimal prej dhjetë vitesh apo burg i përjetshëm nëse vepra është kryer ndaj *...“gazetarit apo punonjësit mediatik, apo personit tjetër që kryen punë me interes publik, gjatë ushtrimit të detyrave profesionale apo lidhur me ushtrimin e detyrave profesionale të cilat i ndërmerr në kuadër të autorizimeve të veta”*⁵⁸

Në nenin 139 – “Detyrim” nga Kodi Penal, poashtu shtohet se formë e kualifikuar e veprës me dënim të paraparë me burg prej gjashtë muajsh deri në tre vjet, si dhe në rast se vepra është kryer ndaj një, *“...avokati, mjeku apo punonjësi tjetër të shëndetësisë, gazetari apo punonjësi tjetër mediatik apo personi tjetër që bën punë me interes publik gjatë ushtrimit të detyrave profesionale apo lidhur me ushtrimin e detyrave profesionale që i ndërmerr në kuadër të autorizimeve të tij”*⁵⁹

Neni 144 – “Kërcënim i sigurisë” me ndryshimet dhe plotësimet e propozuara në Kodin Penal, ndryshohet në mënyrë që plotësohet me një formë të kualifikuar të dënimit më të rëndë të paraparë *“gjatë ushtrimit të dhunës së bazuar në gjini ndaj një gruaje ose dhunës në familje, apo nga urrejtja ose ndaj një personi që është i ndjeshëm në veçanti për shkak të moshës, pengesat e rënda trupore apo shpirtërore apo shtatzëni, do të dënohet me burg prej tre muajsh deri në 3 vite”*⁶⁰ Forma plotëse e kualifikuar e kësaj vepre penale plotësohet edhe nëse e njëjta është kryer mes tjerash ndaj *“...gazetarit apo punonjësit tjetër mediatik apo personit tjetër që bën punë me interes publik, gjatë ushtrimit të detyrave profesionale apo lidhur me ushtrimin e detyrave profesionale...”*⁶¹ Paragrafi 4 nga ky nen i cili me ndryshime do

58 Qeveria e RMV. *Propozim për ndryshim dhe plotësim të Kodit Penal*. Shkup 2021. Qasur më 18.12.2021 <https://bit.ly/3q9buU4>

59 Ibid, 13.

60 Qeveria e RMV. *Propozim për ndryshim dhe plotësim të Kodit Penal*. Shkup 2021,15. Qasur më 18.12.2021 <https://bit.ly/3q9buU4>

të bëhej paragrafi 5, që ishte edhe bazë për ngritjen e kallëzimeve penale kundër autorëve të sulmeve të lartpërmendura ndaj gazetarëve, nuk do të ketë ndryshime të mëdha thelbësore të cilat do të ndikonin në veprimin e PPTH-së apo MPB-së, por mbetet të shihet se çfarë rezultatesh do të sjellë zbatimi i këtyre dispozitave të reja kur do të hyjnë në fuqi. Praktika do të dëshmojë nëse këto ndryshime do të përmirësojnë gjendjet dhe qasjen e organeve të përndjekjes në drejtim të mbrojtjes së gazetarëve dhe punonjësve mediatik, e sidomos gazetarëve, si dhe veprimin sipas detyrës zyrtare.

Poashtu në këto ndryshime dhe plotësime të propozuara, propozohet futja e veprës së re “përndjekje” duke shtuar një nen të ri, nenin 144-a i cili thotë:

“Neni – 144-a

(1) Ai i cili në mënyrë të përsëritur dhe të paautorizuar do të ndjekë, përndjekë apo në mënyrë tjetër do të përzihet në jetën personale të tjetër kujt, apo me të bie në kontakt ose vazhdimisht tenton të bie në kontakt të padëshiruar nga tjetri duke lëvizur në hapësirat ku gjendet ai person, me keqpërdorim të të dhënave personale, me përdorim të mjeteve të informimit, apo në mënyrë tjetër, e keqtrajton psikikisht, e shqetëson dhe e frikëson, dhe me këtë shkakton ndjenjë të pasigurisë, shqetësimit apo frikës për sigurinë e tij apo të ndonjë personi të afërt të tij, do të dënohet me para apo me burg deri në tre vjet.

(2) Nëse vepra e paragrafit (1) të këtij neni është kryer ndaj personit me të cilin autori është apo ka qenë në lidhje intime, apo ndaj fëmijës, do të dënohet me burg prej gjashtë muajsh deri në pesë vite.

(3) Përndjekja për veprën nga paragrafi (1) i këtij neni ndërmerret në bazë të propozimit.”⁶²

Pengimi i personit zyrtar në kryerjen e detyrës zyrtare nga neni 382 i Kodit Penal ndryshohet në paragrafin 3, respektivisht intervenohet në formën kualifikuese të kësaj vepre për të cilën është paraparë dënim me burg prej gjashtë muajsh deri në pesë vite, kështu që në të ardhmen ky nen do të diktojë që “(3)Ai

62 Ibid, 16.

që veprën nga paragrafet (1) dhe (2) të këtij neni do ta kryejë ndaj një personi zyrtar, avokatit, mjekut apo punonjësit shëndetësor, gazetarit apo punonjësit tjetër mediatik, apo ndaj personit që kryen punë me interes publik gjatë ushtrimit të punëve profesionale apo lidhur me ushtrimin e detyrave profesionale që i ndërmerr në kuadër të autorizimeve të veta, apo ndaj personit i cili ndihmon gjatë ushtrimit të detyrave për sigurinë publike apo mbrojtjen e rendit kushtetues të Republikës së Maqedonisë së Veriut, të cilat kanë të bëjnë me pengimin apo zbulimin e veprës penale, kapjes së autorit të ndonjë vepre penale, ruajtjes së rendit dhe qetësisë publike apo ruajtjes së personit të arrestuar, do të dënohet me burg prej gjashtë muajsh deri në pesë vite”.⁶³

Ministri i drejtësisë Bojan Mariçiq lidhur me risitë në Kodin Penal dhe inkorporimin e veprës “përndjekje” me të cilat mbrojtja e punonjësve mediatik dhe grave ngritet në një nivel shumë më të lartë, deklaroi:

“Në të ardhmen sulmi ndaj punonjësve mediatik do të trajtohet njësoj sikurse sulmi ndaj një personi zyrtar. Po vendosim dënime të rrepta për kërcënimet për sulm ndaj gazetarëve. Në mënyrë shtesë, në të ardhmen prokuroria do të veprojë sipas detyrës zyrtare gjatë këtyre rasteve. Kjo ishte një kërkesë e madhe e shoqatave të gazetarëve, përfaqësuesit e të cilëve kanë marrë pjesë aktive në Grupin e punës i cili i përgatiti ndryshimet në Kodin Penal.”⁶⁴

Në mënyrë shtesë, nëpërmjet zbatimit të Konventës së Stambollit, precizohet mbrojtja e grave në mënyrë ligjore dhe futen edhe vepra të reja penale të cilat deri tani nuk kanë ekzistuar tek ne, ndërsa me to gratë në mënyrë ligjore mbrohen nga shqetësimi dhe sulmet.

“Me veprën e re “përndjekje”, parashohim sanksione më të rrepta për shqetësim edhe nëpërmjet internetit, diçka që për fat të keq po ndodhë gjithnjë e më shpesh. Tani, ai që në mënyrë të paautorizuar do të ndjekë, përndjekë apo në mënyrë tjetër do të përzihet në jetën personale të ndonjë personi tjetër, apo dëshiron të vendosë kontakt të padëshiruar me të, duke lëvizur në hapësirat ku gjendet ai person, duke keqpërdorur të dhënat personat, duke përdorur mjetet e informimit publik dhe mjetet e tjera të komunikimit, apo në mënyrë tjetër keqtrajton psiqikisht, shqetëson apo frikëson atë, do të dënohet me para apo me burg deri në tre vjet.”⁶⁵

63 Qeveria e RMV-së. Propozim për ndryshime dhe plotësim të Kodit Penal. Shkup 2021, 22. Qasur më 18.12.2021 <https://bit.ly/3q9buU4>

64 Akademik.mk. M.V Me veprën e re penale “përndjekje” parashihen sanksione më të rrepta për shqetësim edhe nëpërmjet internetit. Shkup 2021. Qasur më 18.12.2021 <https://bit.ly/3qD7IND>

65 Ibid.

Nëse ndryshimet e përmendura votohen në organin ligjvënës, ka shpresa se nëpërmjet zbatimit të formave të kualifikuara të veprave që janë të bazuara në gjini (vepra penale me sanksione më të rrepta) do të krijohej një klimë parandaluese nga autorët e mundshëm. Sulmet në internet ndaj gazetareve si për shembull, ngacmimi dhe frikësimi në internet janë plotësisht të bazuara në gjini, dhe provokohen më tej nga ushtrimi i detyrave profesionale gazetareske.

Nga kjo rrjedh se sulmet në internet ndaj gazetareve i plotësojnë kushtet që të bien nën formën kualifikuese të veprave penale të përshkruara më lartë për të cilat janë paraparë dënime më të rrepta për autorët. Shpresojmë se në të ardhmen nëse këto dispozita hyjnë në fuqi, do të avancohet siguria e gazetarëve në mënyrë të përgjithshme, si në sferën në internet ashtu edhe në jetën reale, dhe se do të ndikohet në mënyrë parandaluese që të zbrapsen autorët eventual që të kryejnë këto vepra.

15

LLOJE TË SULMEVE NË INTERNET NDAJ GAZETAREVE



TROLLIM



NGACIM
KIBERNETIK



GJUHË E
URREJTJES




DOKSING



TURPËRIM PUBLIK



PËRNDJEKJE NË INTERNET



FRIKËSIM DHE KËRCËNIM

Në fotografi shfaqen llojet e sulmeve dhe kërcënimeve me të cilat përballen femrat në përgjithësi edhe ato që merren me profesionin e gazetarisë (nga e majta në të djathtë):

- **Ndjekja në internet/përndjekja** – nënkupton malltretim dhe shqetësim nëpërmjet hapësirës së internetit dhe nëpërmjet shfrytëzimit të teknologjive dhe platformave të ndryshme. Mund të manifestohet nëpërmjet dërgimit të porosive shqetësuese elektronike, porosive tekstuale, shenjzimit (tag) të viktimës apo “@-përmendjes” në rrjetet sociale; këto lloje të sulmeve më së shpeshti janë të organizuara dhe të vazhdueshme.
- **Doksing** – praktikë në internet e hulumtimit dhe emetimit të informacioneve private apo personale për personin – siç është numri i telefonit apo posta elektronike apo adresa e shtëpisë – në hapësirë që praktikon dhe nxitë frikësim apo kërcënim ndaj atij personi. Kjo pastaj mund të shkaktojë apo të inkurajojë dukuri të fushatave për shqetësim nëpërmjet internetit, pasi që një numër i madh i personave fitojnë informacione për ta kontaktuar në mënyrë direkte viktimën.⁶⁶
- **Trollim** – kjo shpesh përfshinë mesazhe të dëmshme apo komunikim për person të caktuar që i dërgohen një personi të tretë, në vend se t’i dërgohen drejtpërdrejt viktimës (të ashtuquajtura komunikime indirekte). Këto komunikime si pasojë mund të arrijnë deri tek viktima dhe të shkaktojnë shqetësim, stres apo frikë.⁶⁷
- **Ngacmim kibernetik** – është dhunë që kryhet nëpërmjet mjeteve elektronike dhe definohet si publikimin i fotografive apo tekstit frikësues, shqetësues, poshtërues në internet. Kjo mund të bëhet nëpërmjet një “telefoni të mençur”, kompjuteri, laptopi, tableti apo platforme në internet për lojë. Mund të zbatohet nëpërmjet një numri të madh të shërbimeve mobile dhe në internet, siç janë tekstet, posta elektronike, ueb faqet për lidhje sociale, ueb faqet për hosting, aplikacionet për shkëmbim mesazhesh (mesenxher), shërbimet për shpërndarjen e fotografive apo bisedave, ueb kamerave, aplikacioneve për mësim vizual, si dhe lojërave në internet.⁶⁸

66 Bogdanov, K. Breshkovski, I. Sekullovska, D. “Përmirësim i sigurisë së gazetarëve nëpërmjet ndryshimit të Kodit Penal” Shkup: KAS, SHGM, 2020, 28.

67 Ibid, 28.

68 Filip Spirkovski. “Doracak për ballafaqim me dhunën” Moduli 5 – Dhuna kibernetike. Shkup Organizata civile: Gazetarë për të drejtat e njeriut, 2018, 2.

- **Gjuhë e urrejtjes** – nënkupton shprehjen e urrejtjes për grup të caktuar. Përdoret për të ofenduar një person në bazë të përkatësisë racore, etnike, fetare apo grupi tjetër ku ai ose ajo përkasin. Gjuha e tillë synon që ta dënojë apo ta paraqesë si çnjerëzor individin apo të shprehë kundër tyre mllef, urrejtje, dhunë apo përçmim. Dërgon mesazh për inferioritet të anëtarëve të grupit dhe i dënon, poshtëron, dhe përmban përplot urrejtje. Praktikisht, e gjithë shprehja raciste, ksenofobike, homofobike dhe gjithë pjesët e shprehjes identitare sulmuese, mund të futen nën emrin e gjuhës së urrejtjes.⁶⁹
- **Turpërim publik** – apo turpërim në internet është formë e turpërimit publik ku caku i sulmit ekspozohet në poshtërim në hapësirën e internetit, sidomos nëpërmjet rrjeteve sociale apo në mediat e lokalizuara si për shembull grupet në internet në platformat e ndryshme, duke shpërndarë të dhëna personale, fotografi apo komunikim privat me viktimat.
- **Frikësim dhe kërcënim** – kërcënimet dhe frikësimet në internet paraqesin dërgim të mesazheve dhe komenteve me përmbajtje kërcënuese apo ofenduese nëpërmjet platformave të ndryshme në internet. Sulmet e tilla janë më të shpeshta ndaj gazetarëve sipas Regjistrimit të SHGM-së, sepse sulmuesi thjesht ka më shumë vetëbesim nëpërmjet hapësirës në internet pasi që i ofron anonimitet apo mobilizim të grupit, i cili i nxitur nga gjuha e urrejtjes në mënyrë të paskrupull e sulmon viktimën.

69 Mihajllova, E. Bačovska, J. Shekerxhiev, T. "Liria e shprehjes dhe gjuha e urrejtjes" Shkup. OSBE 2013, 25.

16

REKOMANDIME PËR AVANCIMIN E SIGURISË SË GAZETARËVE ME FOKUS MBROJTJEN NË INTERNET

Sulmet ndaj gazetarëve nëpërmjet gjuhës së urrejtjes, e cila më së shpeshti shprehet nëpërmjet rrjeteve sociale apo nëpërmjet aplikacioneve për komunikim, duhet të merren me seriozitet nga institucionet e sistemit, respektivisht nga organet e përndjekjes. Viktimat e këtij lloji të kriminalitetit nuk mund të lihen vetë që të kërkojnë drejtësi para gjykatave. Të gjithë aktorët të cilët në çfarëdo mënyre ndikojnë ndaj sigurisë së gazetarëve në jetën reale, e sidomos në internet, edhe atë duke theksuar sulmet e bazuara në gjini ndaj gazetarëve, duhet që të angazhohen në mënyrë aktive për avancimin e sigurisë së gazetarëve, si dhe të japin kontribut për mbrojtjen e tyre.

Siç tregoi edhe analiza në këtë raport, reagimi i pakoordinuar institucional dhe *“mungesa e rregullimit kontribuon që të përdoret gjuha e urrejtjes sidomos në kushte të mobilizimit intensiv politik, por edhe në komunikimin e përditshëm me përdoruesit e këtyre rrjeteve.”*⁷⁰ Sulmet në internet ndaj gazetarëve sidomos ndaj gazetarëve, po shënojnë rritje pas paraqitjes së krizës me pandeminë e Kovid-19, si dhe në periudhë të turbulencave politike, apo kur janë mbajtur zgjedhjet, gjatë regjistrimit të popullsisë apo thjeshtë kur gaze-

70 Marollov, D. – Stojanovski, S. *“Gjuha e urrejtjes në rrjetet sociale në Republikën e Maqedonisë”*, Shtip UGD Shtip 2016, 20.

tarët kanë ushtruar detyrën e tyre dhe kanë informuar opinionin për çështje me interes publik.

Pjesa përfundimtare e këtij raporti ofron një rishikim të rekomandimeve të cilat iu drejtohen apo prekin të gjithë aktorët që mund të kontribuojnë për avancimin e sigurisë në internet të gazetarëve në nivel kombëtar. Vlerësojmë se rekomandimet afatshkurtër palët e interesuara mund dhe duhet që në afat sa më të shkurtër t'i zbatojnë në mënyrë që të ndjehet efekti i zbatimit të tyre, ndërsa rekomandimet ose masat afatgjate duhet të krijojnë sistem të qëndrueshëm për mbrojtje të sigurisë në internet të gazetarëve, sidomos të gazetarëve në afat më të gjatë, me çka do të krijohej një bazë, në përputhje me rekomandimet e parterëve vendas dhe atyre ndërkombëtarë.

REKOMANDIME AFATSHKURTËR:

- Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut të votojë sa më shpejt propozim ndryshimet e Kodit Penal për të cilat janë konsultuar shoqatat e gazetarëve dhe sindikatat, ku janë aplikuar format e kualifikuara të veprave penale që prekin gazetarët;
- Të rritet efikasiteti i punës së Sektorit të MPB-së për kriminalitet kompjuterik dhe forenzikë digjitale, nëpërmjet rritjes së ekipit dhe mundësive teknike me qëllim që sa më lehtë të gjenden autorët e sulmeve në internet ndaj gazetarëve dhe punonjësve mediatik;
- Të formohen reparte të posaçme në PPTH dhe në gjykata që do të jenë të trajnuar dhe specializuar për sigurinë e gazetarëve dhe punonjësve mediatik nëpërmjet mbrojtjes dhe avancimit të lirisë së shprehjes, në pajtueshmëri me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ);
- Të përmirësohet kultura e komunikimit publik ndërmjet aktorëve politik për të mos nxitur sulmet ndaj gazetarëve në jetën reale dhe në internet, sidomos sulmet me bazë gjinore ndaj gazetarëve, edhe atë nëpërmjet zotimeve publike dhe nënshkrimit të deklaratave formale për zbatimin e praktikave të mira nëpërmjet rrjeteve sociale dhe internetit;
- Të hapen linja të shpejta telefonike 24 orëshe për gazetarët viktime të sulmeve në internet dhe të bëhet shpërndarja e të dhënave të kontaktit nga Sektori për kriminalitet kompjuterik dhe forenzikë nëpër redaksitë e gazetarëve.

REKOMANDIME AFATGJATA:

- Të organizohen mbledhje koordinuese në PPTH dhe gjykata me qëllim të harmonizimit të praktikës së zbatimit të dispozitave nga Kodi Penal që kanë të bëjnë me mbrojtjen e sigurisë së gazetarëve në përgjithësi, dhe me theks të veçantë mbrojtjen e sigurisë në internet të gazetarëve;
- Të parandalohet gjuha e urrejtjes me bazë gjinore që është vazhdimisht prezent në hapësirën e internetit, sidomos ndaj gazetarëve, edhe atë nëpërmjet përmirësimit të punës ndër-sektoriale, nga njëra anë MPB, PPTH dhe gjykatat, e nga ana tjetër sektori civil që është aktiv në këtë fushë dhe institucionet arsimore;
- Të ndiqen dhe dokumentohen rastet e gjuhës së urrejtjes dhe sulmeve të bazuara në gjini ndaj gazetarëve në hapësirën e internetit nga ana e sektorit civil, gazetarëve dhe mediave me qëllim nxitjen e institucioneve që të ndërrin masa adekuate për të luftuar këto dukuri;
- Të inkuadrohen këto tema dhe çështje të sigurisë së gazetarëve në jetën reale dhe në internet në planet strategjike për zhvillim dhe punë të MPB-së, PPTH-së, gjykatave dhe të gjitha institucioneve të cilat kanë rol dhe mund të ndikojnë për përmirësimin dhe avancimin e sigurisë së gazetarëve në internet dhe jetën reale;
- Të gjithë aktorët të kontribuojnë për ngritjen e vetëdijes tek gazetaret që t'i denoncojnë këto sulme para institucioneve, para shoqatave të gazetarëve dhe redaksive ku punojnë;
- Të intensifikohet bashkëpunimi ndërmjet shoqatave profesionale të gazetarëve dhe MPB-së, PPTH-së dhe gjykatave, nëpërmjet veprimeve dhe projekteve konkrete me qëllim koordinimin më të mirë dhe qasjen e hapur ndaj çështjeve që prekin sigurinë e gazetarëve;
- Me qëllim kundërvënien e sulmeve në internet ndaj gazetarëve në formë të “Doksing”-ut, “Trollim”-it, dhe “përndjekjes”, dhe formave tjera të ngacmimit në internet, institucionet si Agjencia për mbrojtje të të dhënave personale dhe MPB të ofrojnë programe edukative për gazetaret femra se si të mbrojnë të dhënat e tyre personale në hapësirën në internet dhe si ato të dhëna të mos keqpërdoren;

- Të përmirësohet transparenca aktive e organeve të përndjekjes gjatë procedurave për mbrojtje të të drejtave të gazetarëve, dhe zbatim të duhur të Ligjit për qasje të lirë në informacione me karakter publik;
- Të ketë përmirësim të vazhdueshëm të profesionalizimit dhe njohurive të gjykatësve, prokurorëve publik, avokatëve, për temat që kanë të bëjnë me sigurinë e gazetarëve dhe punonjësve mediatik, lirinë e shprehjes, gjuhën e urrejtjes të bazuar në gjini dhe diskriminimin me bazë gjinore.

LITERATURA E SHFRYTËZUAR:

- Bogdanov, K. Breshkovski, I. Sekullovski, D. *“Përmirësim i sigurisë së gazetarëve nëpërmjet ndryshimeve të Kodit Penal”* Shkup : KAS, 2020
- Ivanov, Z. Markovski, I. *“Kronikë për (pa) sigurinë e gazetarëve”*: Shkup : SHGM 2019
- Markoski, A. *“Rishqyrtim i gjuhës së urrejtjes nëpërmjet prizmit prokurorial, provë për procedurën dhe leksionet e mësuara”* Shkup: AGJPP “Pavell Shatev” 2021
- Marollov, D. Stojanovski, S. *“Gjuha e urrejtjes në rrjetet sociale në Republikën e Maqedonisë”* Shtip : UGD Shtip 2016
- Mihajlova, E. Baçovska, J. Shekerxhiev, T. *“Liria e shprehjes dhe gjuha e urrejtjes”* Shkup: OSBE 2013, 25
- Mrgja, D. Murtezi, E. Bellovska, K. *“Sulmet ndaj gazetarëve dhe punonjësve mediatik më 27 prill të vitit 2017”* Shkup: SHGM 2021
- OSCE, *What Key Actors Can Do For The Safety Of Female Journalists Online*. Vjenë: OSBE 2020
- Sabrioski, S. Atovska, K. *“14 sulme ndaj gazetarëve, 14 sulme ndaj demokracisë”*, Shkup: SHGM 2021
- KE. Platforma, *Annual Report by the partner organisations to the Council of Europe Platform to Promote the Protection of Journalism and Safety of Journalists 2021* Strazburg: SE 2021
- KE. Platforma, *Annual Report by the partner organisations to the Council of Europe Platform to Promote the Protection of Journalism and Safety of Journalists 2020* Strazburg: KE. Platforma 2020
- KE. Platforma, *Annual Report by the partner organisations to the Council of Europe Platform to Promote the Protection of Journalism and Safety of Journalists 2019*. Strazburg: KE. Platforma 2019
- Sekullovski, D. Sulejman, D. *“Tregues për nivelin e lirisë së mediave dhe sigurisë së gazetarëve për vitin 2019”* Shkup : SHGM 2020
- Spirovski, F. *“Doracak për ballafaqim me dhunën, Moduli 5 – Dhuna kibernetike* Shkup: Organizata civile: Gazetarë për të drejtat e njeriut 2018
- Spirovski, M. Todorovska-Kostovska, V. *“Tregues për nivelin e lirisë së mediave dhe sigurisë së gazetarëve për vitin 2020”* Shkup: SHGM 2020

www.znm.org.mk

Shoqata e gazetarëve të Maqedonisë

Gradski Zid, blok 13 1000, Skopje, Republika e Maqedonisë së Veriut
00389 (02) 3298-139 contact@znm.org.mk

